



KONTABILITET

KLASA X

- I. Pasqyrat financiare
- II. Procesi I regjistrimit kontabël
- III. Pasqyrat financiare dhe rregullimet



Përmbajtja	
Organizimet e bizneseve dhe llojet e tyre	4
Organizimet formale të biznesit.....	5
Entitetet joprofitabile (jo fitimprurëse).....	6
Roli i kontabilitetit për biznesin.....	7
Historiku i shkurtër i kontabilitetit.....	7
Definimi i kontabilitetit.....	7
Përdoruesit e informatave të kontabilitetit financiar.....	12
Kontabiliteti i menaxhmentit	14
Dedikimi i informatave të fushave të kontabilitetit	15
Korniza e rregullave të kontabilitetit dhe pasqyrat financiare	17
Udhëzuesit e kontabilitetit	19
Supozimet	20
Parimet e kontabilitetit.....	22
Parimi i kostos.....	22
Parimi i realizimit (njohjes së të hyrave)	22
Parimi i shkakësisë (i njohjes së shpenzimeve)	23
Parimi i publikimit të plotë	23
Parimi besueshmërisë (objektivitetit)	24
Kufizimet (Constraints)	24
Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare	27
BILANCI I GJENDJES	29
Formati horizontal i bilancit.....	32
Klasifikimi i bilancit	32
Pasuria afatshkurtër (korente).....	33
Kapitali aksionar	34
Ndikimi i transaksioneve në ekuacionin e bilancit	36
PASQYRA E TË ARDHURAVE	41
Formatet e pasqyrës së të ardhurave	42
Pasqyra e të ardhurave sipas natyrës së shpenzimeve	47
PASQYRA E RRJEDHAVE TË PARASË (keshit).....	47

Metoda direkte	49
Metoda indirekte	51
Metoda direkte	52
Njësitë e procesit kontabël	61
Sistemi i regjistrimit të dyfishtë	61
Lloraria (konto) T	62
Debiti dhe krediti	63
Zgjerimi i ekuacionit të bilancit	64
Saldot (gjendjet) normale të llogarisë	65
Analiza dhe evidenca e transaksioneve në llogaritë e librit kryesor	69
Regjistrimi i transaksioneve në ditar	73
Bilanci vërtetues (provues)	81
Bilanci vërtetues përpara rregullimeve	83
Kuptimi për pagat	84
Qëllimi i llogaritjes së pagave	85
Ndarja e pagave	86
Tatimet dhe kontributet në paga	88
Tabela 4. Shkallët tatimore. Burimi: www.atk-ks.org	91
Kursimet Pensionale	91
Pagat bruto.	95
Pagat neto	96
Mënyrat e llogaritjes së pagës bruto dhe pagës neto	97

Kontabiliteti si gjuhë universale e komunikimit

Njerëzit në përditshmërin e tyre, në një formë apo një menyrë tjetër, në vazhdimësi e përdorin kontabilitetin. Shembull tipikë që lidhen me natyrën e kontabilitetit janë: kur qytetarët hapin llogarotë e kursimeve në bankat e ndryshme, nxënësit e studentët bëjnë një plan të shpenzimeve për studimet e tyre (kostot e konviktit, kostot e librave, kostot e udhëtimit, ushqimit) ndërsa bizneset e përdorin informacionin kontabël për vlerësimin e performaceve (suksesit) të tyre.

Shtrohet pyetja, a është kontabiliteti i rëndësishëm për ju? Përgjigjja korrekte është po. Kontabiliteti është i rëndësishëm në jetën tuaj personale, sidomos në qoftë se ju jeni menaxher ose pronar i një biznesi.

Le të supozojmë se ju keni një shitore parfumerie në Pejë dhe pretendoni t'a zgjeroni aktivitetin tuaj biznesor në Prishtinë, duke e hapur edhe një shitore tjetër. Në këtë rast juve ju nevojitet një financim shtesë. Atëherë informacioni kontabël i biznesit tuaj është i domosdoshëm të përdoret nga banka, në mënyrë që ajo të marrë vendimin për lejimin e një krediti që ju nevojitet juve.

Organizimet e bizneseve dhe llojet e tyre

Llojet e bizneseve

Në çdo shtet ekzistojnë organizime të ndryshme shoqërore. Organizimet në shoqëri, të cilat qëllim primar e kanë profitin, emërtohen biznese. Varësisht nga lloji veprimtarisë operuese (afariste) të tyre klasifikohen në tri grupe kryesore:

- *Bizneset prodhuese*
- *Bizneset tregtare*
- *Bizneset shërbyese*

Bizneset prodhuese imputet e tyre (materialin direkt, punën direkte dhe shpenzimet e përgjithshme direkte) i transformojnë në produkte të gatshme, të cilat pastaj u shesin blerësve të ndryshëm, siç janë p.sh., bizneset tregtare dhe konsumatorët finalë.

Bizneset prodhuese**Produktet**

- Fruti ----- Lëngje
- Lesna ----- Dyer dhe dritare
- Silkapor ----- Tulla shamoti

Bizneset tregtare kryesisht e blejnë mallin prej bizneseve prodhuese dhe të tjera, të cilat pastaj ua shesin të tretëve, siç janë konsumatorët finalë.

Bizneset tregtare**Mallrat**

- Kastrati ----- Mallra të konsumit të gjerë
- Delfina ----- Mobileri
- Flamuri ----- Tekstil

Bizneset shërbyese aktivitet primar e kanë ofrimin e shitjes së shërbimeve për intensitetet e ndryshëm.

Bizneset shërbyese**Shërbimet**

- Mendi ----- Transport
- IPKO ----- Shërbie internet, TV.
- Raiffaisen bank ----- Shërbime financiare

Organizimet formale të biznesit

Llojet më të zakonshme të organizimit formal të bizneseve në të gjitha shtetet e botës janë:

- a) *Bizneset inokose (individuale)*
- b) *Bizneset partnere (ortake)*
- c) *Korporatat (shoqëritë aksionare)*

Bizneset inokse janë në pronësi të një individi. Pronari i biznesit mund të jetë menaxher dhe punëtor i biznesit. Kontabiliteti i këtyre bizneseve mbështetet në parimin përkatësisht presupozimin e entitetit afarist. Praktikisht kjo nënkupton se kontabiliteti i këtyre firmave duhet të jetë plotësisht i veçantë nga pasuria personale e tij.

Në aspektin ligjor këto biznese janë me përgjegjësi të pakufizuar, çka do të thotë se në qoftë se falimenton biznesi, në përbushjen e detyrimeve ndaj të tretëve, krahas pasurisë së firmës duhet të

përdoret edhe pasuria e tij personale. Shembuj tipikë të këtij lloji janë bizneset e vogla shërbyese dhe tregtare si p.sh., frizerët, avokaturat, fermant, shitoret antike, libraritë, etj.

Në totalin e bizneseve të një shteti, bizneset e vogla apo individuale bënë pjesë në përqindjen më të lartë, afërsisht 60 – 80% e bizneseve janë individuale.

Disavantazhi kryesor i tyre është në *kufizimet që posedojnë lidhur me resurset materiale* dhe financiare.

Bizneset partnere (ortakëritë) janë në pronësi të dy ose më shumë pronarëve individualë. Ky lloj i bizneseve në shumë karakteristika është i ngjashëm me bizneset individuale.

Dallimi kryesor ndaj bizneseve individuale qëndron me rastin e themelimit të bizneseve partnere. Këto krijohen mbi bazën e një marrëveshjeje gojore ose me shkrim dhe në këtë rast investimet e tyre të veçanta, mbahen ndaras në totalin e kapitalit, në bazë të shumave të investuara, me fjal të tjera në bilancin e firmës, kapitali i secilit pronar prezentohet në mënyrë të veçantë. Gjithashtu, edhe te këto biznese kontabiliteti mbështetet mbi parimin e entitetit afarist, që don të thotë se kontabiliteti i bizneseve partnere mbahet ndaras nga pasuritë personale të tyre.

Ortakërit janë biznese me përgjegjësi të pakufizuar, por nuk do të thotë se të gjithë partnerët të jenë në përgjegjësi të pa kufizuar. Mjafton njëri prej partnerëve të jetë me përgjegjësi të pakufizuar.

Zakonishtë ortakëritë formohen në shërbime tregtare apo edhe praktika profesionale, si juristë, arkitektët, mjekët, auditorët, etj.

Në totalin e bizneseve kjo formë biznesi në shumë shtete participon me 5 – 12%.

Korporatat janë entitete legare të krijuara mbi bazën e ligjeve të veçanta të shoqërive aksionare të çdo shteti. Pronësia në korporatë krijohet mbi bazën e shpërndarjes dhe transpferimit të aksioneve të rregullta, të cilat shiten në tregjet e kapitaleve. Fillimi i punës së korporatës bëhet pasi që më parë të jetë miratuar kontrata e punës nga komisionet e letrave me vlerë në suaza të çdo shteti. Emertimi i aksioneve të rregullta nga korporata i sigurojnë asaj kapitalin aksionar.

Avantazhi kryesor i korporatës është në krijimin e shumave të mëdha të mjeteve monetare brenda një kohe të shkurtër.

Korporatat edhe pse në totalin e bizneseve, numerikisht janë në përqindje të vogël në suaza të çdo shteti, ato megjithatë posedojnë në pronësi të tyre përqindje të lartë të kapitalit monetar.

Entitetet joprofitabile (jo fitimprurëse)

Entitetet të cilat janë të themeluara dhe regjistruara në organet kompetente mirëpo nuk e kanë sikur qëllim primar realizimin e fitimit, emërtohen si entitetet jo profitabile apo jo biznese.

Entitetet jo fitimprurëse janë të përkushtuara në plotsimin e nevojave të ndryshme humanitare për segmente të caktuara të shoqërisë, si shendetësi, arsim, kulturë etj. Organizata apo entitete jo profitabile konsiderohen: agjencitë qeveritare, shkollat, spitalet, institucionet fetare ose religjioze, etj.

Roli i kontabilitetit për biznesin

Historiku i shkurtër i kontabilitetit

Kontabiliteti ka lindur herët që me lindjen e familjes njerezore, shkrimit dhe të shkëmbimit [parasë dhe tregtisë], pra me lindjen e vetë qytetërimit. Krijimi dhe akumulimi i pasurisë imponoi evidentimin e saj. Format më të lashta të kontabilitetit hasen tek të gjitha qytetërimet e lashta – Egjypti, Mesopotamia, Grekët, Romakët, Kina, etj.

Llogaritë dhe evidencat e para kontabël janë gjendur në formë të pllakave të baltës. Në kohët e lashta kontabiliteti ka lindur dhe ka shërbyer si bazë për evidentimin e pasurisë familjare, të tempujve dhe të sundimtarëve, për të informuar se çfarë duhet të prodhojnë më shumë dhe më pak, se çfarë duhet dhe sa të shkëmbejnë, se çfarë detyrimesh janë për tu paguar e të drejtash për tu marrë, për taksat, etj.

Megjithatë, origjina e kontabilitetit, në përgjithësi i atribuohet matematikanit të famshëm Italian të Renesansës, Luca Pacioli. Në këtë periudhë, Pacioli i famshëm, ishte mik dhe tutor i Leodardo Da Vinçit dhe Kristofor Kolombos. Në vitin 1494 ky matematikan dhe prift i famshëm, i asaj kohe, botoi tekstin: **Suma de arithmetica, Geometria, Proportione et Proportionalite**. Në këtë tekst ai përshkruan një sistem të llogarimbajtjes së dyanshme, i cili sistem ishte kërkuar të mbahej nga investitorët, të cilët paratë e tyre ua besonin menaxherëve të firmave. Nga ajo kohë e gjerë më tani, zhvillimet e kontabilitetit në tërë botën u janë nënshtruar ndryshimeve të rëndësishme.

Definimi i kontabilitetit

Kontabiliteti në një subjekt biznesi është mjet për të matur dhe përshkruar veprimet ekonomike dhe rezultatet e këtyre veprimeve. Kontabiliteti është “kimia” e shndërrimit të ngjarjeve ekonomike dhe financiare që përjeton një firmë, në të dhëna ekonomike për dobi të vendimeve të lexuesve apo përdoruesve të tyre. Vetëm disa prej lexuesve të këtij libri bëhen kontabilistë, ndonëse të pothuajse të gjithë kanë përdorur informacion kontabël sepse kanë kaluar nëpër duar dokumenta të

ndryshme –p.sh., sa herë që blejnë shitësit i ofrojnë një faturë shitjeje, sa herë që depozitojnë ose sa herë terheqin para nga banka ata përftojnë një dëshmi/mandat pagese ose arkëtimi, një çek, etj. Dokumenta të ngjashëm përftohen edhe kur huamarrin ose huajapin, kur investojnë në një firmë, kur paguajnë qiranë, energjinë, kur regjistrohen në shkollë etj.

Shumë njerzë, në jetën e përditshme, kontabilitetin e kuptojnë si një llogarimbajtje.

Kontabiliteti duhet dalluar nga mbajtja e llogarive, sepse kontabiliteti (accounting) e përfshin mbajtjen e llogarive, ndërsa mbajtja e llogarive është pjesë e kontabilitetit. Mbajtja e llogarive (bookkeeping) kufizohet vetëm me regjistrimin e ngjarjeve kontabël [transaksioneve, hyrje-arkëtime dhe dalje-pagesa, etj.] me dorë ose me kompjuter. Kontabiliteti përveç mbajtjes së llogarive rrok analizën e transaksioneve apo të ngjarjeve, mënyrën e raportimit të tyre në evidencat e raportet financiare si dhe metodat e standardet e nxjerrjes në pah apo të shpalesjes së informacionit të përpunuar në dobi të interesave të lexuesve e përdoruesve të tij.

Ndryshe nga kjo, kontabiliteti është process I identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.

Roli I sistemit informative menaxhimentit është aq I rëndësishëm dhe aq I madh, sa që ai, aktualisht, krahas veprimtarisë afariste dhe menaxhimit të ndërmarrjes, është bërë factor determinues I zhvillimit të saj.

■ ***Kontabiliteti është procesi i identifikimit, matjes, evidentimit, përpunimit, i ruajtjes dhe i komunikimit të të dhënave që përjetohen përgjatë një periudhe të dhënë kohe, të organizuara si informacion në librat e evidencat kontabël të një subjekti biznesi, për të mundësuar verifikime, vlerësime, interpretime, gjykime dhe vendim-marrje të lexuesve apo përdoruesve të tyre.***

■ ***Kontabiliteti është gjuha e biznesit që të afteson për të shkruar, lexuar, kuptuar dhe komunikuar atë. Kontabiliteti si gjuhë e biznesit ka gramatikën, rregullat dhe standardet e veta. “Gramatika” kontabël përfshin konceptë dhe parime për ta bërë kontabilitetin një gjuhë të lexueshme si nga palët brenda firmës ashtu dhe jashtë saj, si ato të vendit ashtu dhe ato të huaja.***

Sistemit informativ të kontabilitetit, pa dyshim, në këtë drejtim, I takon vendi dhe roli qendror për shkak se informatat e tij kanë aftësi që, në mënyrë cilësore dhe transparente, të paraqesin, në çdo kohë, ngjarjet afariste, situatën e pasurisë, gjendjen financiare, rentabilitetin e saj etj. Nga shkaku I

veqorive të tilla që I posedon sistemi I kontabilitetit, me të drejtë, shumë autor e quajnë reporter të jetës afariste dhe gjuhë universal të biznesit bashkëkohor. “Si metodologji shkencore dhe profesionale, kontabiliteti është art I interpretimit, I matjeve dhe prezantimit të rezultateve nga aktivitetet ekonomike”.

Për menaxhmentin, informatat e kontabilitetit paraqesin bazën informative për marrjen e të gjitha llojeve të vendimeve. Vetëm vendimet e marra mbi këtë bazë mund të jenë cilësore dhe me rrezik të vogël. Edhe për shumë vendime të menaxhimentit të ndërmarrjes, pa marrë parasysh se a janë financiare apo ekonomike, informatat e kontabilitetit janë të rëndësishme.

Për dallim nga të gjitha informatat të tjera në ndërmarrje, për grupet e interesave jashtë ndërmarrjes, informatat e kontabilitetit janë më të besushmet nga që kanë kredibilitet. Atributin e kredibilitetit ato e përfitojnë nga shkaku se janë të kontrulluara nga auditimi I pavarur. Prandaj , nisur nga kualiteti I përmbajtjes dhe I përdorimit të tyre,mund të themi se informatat e kontabilitetit paraqesin premisën nismëtare për menaxhim e fikas të ndërmarrjes dhe për marrjen e vendimeve kualitative afariste.

Sistemi informative I kontabilitetit është përgjegjës për:

- 1) *Identifikimin e resurseve në ndërmarrje*
- 2) *Përcjelljen e transformimit të resurseve të shitura blerësve si mallra she sherbime ose përfitimet nga marrja*
- 3) *Determinimet e kostos të resurseve të përdorura nga ndërmarrja*
- 4) *Raportimin e informacioneve për këto aktivitete për përdorimin intern dhe ekstern.*

Qëllimi kryesor i kontabilitetit është që të sigurojë informata sa më cilësore që do të krijonin bazën për marrjen e vendimeve, po ashtu, sa më cilësore. Për dallim nga e kaluara, kur kontabiliteti nuk ishte i zhvilluar dhe informatat e tij, në përdorim të menaxhmentit financiar, ishin të limituara, si përka cilësia dhe shpejtësia e sigurimit të tyre, ai tani, në aspektin shkencor dhe profesional, ka evaluuar mjaft edhe është bërë faktor kyç për funksionimin e menaxhmentit financiar bashkëkohor.

Zbatimi i teknologjive informative bashkëkohore në ndërmarrje ka bërë të mundur grumbullimin e shpejt të të dhënave interne dhe ekstere, që kanë të bëjnë me aktivitetin ekonomik te saj si dhe në përparimin e tyre për procesimin e informatave të përdorshme në menaxhimin efikas

të ndërmarrjes. Në këtë drejtim, edhe sistemi i kontabilitetit tani shumë shpejt ka mundësi të procesojë, të analizojë dhe t'iu komunikojë të interesuarve informata cilësore me përmbajtje ekonomike dhe financiare.

Struktura organizative e sistemit të kontabilitetit, në radhë të parë, është e varur nga madhësia e ndërmarrjes, por njëkohësisht është qështje profesionale e menaxhmentit në ndërmarrjes. Në ndërmarrjet e mëdha (korporata) përgjegjës për disenjimin, implementimin dhe operacionet, në sistemin e kontabilitetit, është drejtori financiar (z. Presidenti financiar). Pas drejtorit financiar, dy autoritetet më të larta menaxhuese, në praktikën e funksionit financiar, janë trezori(thesari) dhe kontrollori. Përderisa trezori, kompetencat e drejtorit financiar është përgjegjës për të gjitha operacionet monetare, siq janë p.sh. sigurimi i mjeteve financiare, distribuimi i tyre, marrja e kredisë , depoziti i mjeteve monetare etj., kontrollori, në anën tjetër, ka të deleguar autoritetin e drejtorit financiar për menaxhimin e sistemit të kontabilitetit. Operacionet kryesore, në praktikën e sistemit të kontabilitetit janë:

- *Udhëheqja e librit kryesor,*
- *Të kërkesave të arkëtushmëe,*
- *Llogarive të pagushme,*
- *Kontabilitetit të rezervave,*
- *Kontabilitetit të pasurisë fikse etj.*

Dy degët kryesore të kontabilitetit janë:

- a) Kontabiliteti financiar***
- b) Kontabiliteti i menaxhmentit.***

Kontabiliteti financiar-është fushë e kontabilitetit, qëllimi themelor i të cilit është përgaditja e pasqyrave financiare mbi bazën e rregullave të caktuara siq janë: parimet e përgjithshme të pranuarra të kontabilitetit.

Roli i rëndësishëm i kontabilitetit, në vlerësimin e pozitës financiare të ndërmarrjes, pa dyshim operacionalizohet më së miri duke i përdorur analizat e pasqyrave financiare. Favorizimi i përdorimit

të këtyre pasqyrave të kontabilitetit financiar, për vlerësimin e situatës financiare mbi bazën e analizës së tyre, arsyetohet me faktin se grupi integral i pasqyrave financiare u prezanton dhe komunikon të interesuarëve të dhena mbi aktivitetin e ndërmarrjes, të shprehura në vlera monetare.

Ndryshe, relevanca e raporteve financiare mund të komentohet mbi faktin se ato megjithëse i përmbajnë aktivitetet afariste dhe financiare të ndërmarrjes si tërësi, me interpretimin analitik të të dhënave që gjenden në ato raporte, mundësohen identifikimi dhe percjellja e parametrave kryesorë të pozitës financiare, siç janë: likuiditeti, solventiteti dhe profitabiliteti i aktivitetit afarist të saj.

Një grup komplet i pasqyrave financiare, i përgatitur në harmoni me SNK-në, përfshin:

- a) Bilancin e gjendjes*
- b) Pasqyren e të ardhurave*
- c) Një pasqyrë e cila prezanton:*
 - 1) Tërë ndryshimin e kapitalit të vet*
 - 2) Ndryshimin e kapitalit të vet, por jo edhe ndryshimin që është si rezultat i transaksioneve*
- d) Pasqyren e rrjedhave të keshit*
- e) Politikën kontabël dhe njoftimet shtesë.*

Me gjithë faktin se këto pasqyra financiare janë të ndërtuara mbi bazën e njejtë të transaksioneve afariste dhe të shprehjes universale të vlerës së tyre, prapëseprapë ato ofrojnë lloje të ndryshme të informatave lidhur me aktivitetin e ndërmarrjes. Bilanci i gjendjes prezanton pozitën financiare, gjegjësisht pasurinë, kapitalin e vet dhe detyrimet në një datë të caktuar e që në fakt është data e përpilimit të tij.

Përdoruesit e informatave të kontabilitetit financiar

Informatat e kontabilitetit financiar prezantojnë pozitën financiare, përkatësisht pasurinë, detyrimet dhe kapitalin e vet si dhe rezultatin e aktivitetit afarist për një periudhë të caktuar. Ato kanë formë standarde dhe veqoritë që i posedojnë, i bëjnë të favorshme për përdorim, ngase krijojnë bazë të mirë informative për marrjen e shumë vendimeve, si për menaxhmentin ashtu edhe për grupet eksterne.

Informatat e tij u dedikohen përdorimit të menaxhmentit dhe grupeve eksterne të biznesit. **Përdoruesi kryesor intern** është menaxhmenti i ndërmarrjes, në të gjitha nivelet, dhe, në këtë aspekt, më së shumti i nevojitet menaxhmentit financiar. Mbi bazën e këtyre informatave, ai mund të përcaktojë:

- *nevojat për mjete financiare dhe për mjete të tjera,*
- *të vlerësojë efikasitetin e strukturës së kapitalit,*
- *të vlerësojë rregullsinë e vendimeve investuese,*
- *të propozojë korrektura në treguesit e planifikimit,*
- *të përpunojë dhe realizojë politikën e pagave, të dividendës, huazimit etj.*

Është me rëndësi të thuhet se praktikën e ndërmarrjeve në shtetet e zhvilluara, në vazhdimësi, e ka përcjellë interesimi i menaxhmentit, në nivelin më të lartë, për marrjen e vendimeve lidhur me politikat kontabël.

Në këtë aspekt, ai gjithmonë ka vendosur në favor të atyre politikave që mundësojnë krijimin e pasqyrave financiare më zëra sa më të lartë, p.sh. rritja e pasurisë varësisht nga zbatimi i metodës ka kufizuar dukëshëm një veprim të tillë.

Nga grupet eksterne, informatat e kontabilitetit, në radhë të parë, u dedikohen aksionarëve dhe investitorëve potencial të ndryshëm.

Aksionarët ekzistues janë të interesuar për dividendë, prandaj atyre i'u nevojiten këto informata për të mësuar se sa është fitimi i realizuar dhe çfarë është perspektiva e ndërmarrjes, në mënyrë që ata të vendosin t'i mbajnë edhe më tutje apo t'i shesin. Pothuajse për të njëjtin qëllim i përdorin edhe

aksionarët potencial. Duke i vënë në komparacion pasqyrat financiare për ndërmarrjet e ndryshme u ofrohet mundësia që investimet e tyre t'i bëjnë në alternativën më të mirë.

Obligacionmbajtësve, bankave dhe kreditorëve të tjerë, këto informata i'u nevojiten për të mesuar se a do të jetë në gjendje ndërmarrja të përmbush, në afatin e caktuar, detyrimet ndaj kamatës dhe kryegjës.

Organeve shtetërore dhe agjencioneve qeveritare këto informata i'u nevojiten për fushën e ligjeve lidhur me përcaktimin e pagave minimale, kontributit personal, për determinimin e çmimeve në sferën e shërmimeve publike etj.

Autoritetet fiskale i përdorin për të vlerësuar rregullësin e prezantimit të të dhënave, në mënyrë që të mund të konstatojnë se a ka pasur defraudim të tatimit nga ndërmarrja. Organet drejtuese të bursës, nëpërmjet pasqyrave financiare, vlerësojnë pozitën financiare të ndërmarrjes me rastin e regjistrimit të tyre në bursë si dhe me rastin e likuidimit të atyre që janë të regjistruar në bursë.

Shoqatat konsalting, nëpërmjet këtyre informatave, klientëve të tyre iu ofrojnë propozime adekuate lidhur me blerjen e aksioneve, obligacioneve dhe për investime të ndryshme të kapitalit.

Asociacionet e ndryshme industriale i përdorin për statistika të rëndësishme, qoftë në nivelin shtetror të industrisë apo në nivelin ndërkombëtar. Në qoftë se analizat statistikore tregojnë ndojnë konjunktur në suazat e degës industriale, atëherë këto asociacione mund të sigurojnë me lehtësi sponsorim për hulumtime studiuese në degë të ndryshme industriale.

Personeli i ndërmarrjes, mbi bazën e pasqyrave financiare, mund të marrë vendime të ndryshme p.sh. lidhur me vazhdimin e punës, për ofertën e pagës, për planin e pensionit, për planin rizidual të tij etj

Kontabiliteti i menaxhmentit

Është “fushë e kontabilitetit që si qëllim kryesor ka përgatitjen, raportimin dhe interpretimin e informacioneve të kontabilitetit që kanë përdorimin intern në ndërmarrje, për marrjen e vendimeve të ndryshme”.

Edhe pse kontabiliteti i menaxhmentit është shumë i lidhur me kontabilitetin financiar, në praktikë, te ndërmarrjet e mëdha, këto bransha (degë) organizohen ndaras. Meqenëse informatat e këtij kontabiliteti përdoren për nevojat interne të menaxhmentit, ato nuk janë standardizuara, gjë që do të thotë se për sajimin e tyre nuk ekzistojnë restriksione lidhur me zbatimin e rregulloreve të caktuara (p.sh. parimeve etj). Edhe pse shumica e informatave të kësaj branshe nuk janë me karakter financiar, megjithatë, në përgjithësi, mund të konstatojmë se informatat e këtij kontabiliteti paraqesin një bazë solide për marrjen e shumë vendimeve afariste në të gjitha funksionet e ndërmarrjes dhe për të gjitha nivelet e menaxhmentit. Sipas mendimit të shmuë shkenctarëve, literaturës kontabël, kontabiliteti i menaxhmentit përdoret nga ana e menaxherëve për marrjen e vendimeve lidhur me:

- a) *planifikimin operativ (afarist)*
- b) *kontrollin dhe*
- c) *menaxhimin e kostos.*

Marrja e vendimeve për **planifikimin operativ** kërkon prej menaxherëve që t’i identifikojnë qëllimet dhe të zhvillojnë strategjitë adekuate për realizimin e atyre qëllimeve.

Vendimet për **kontroll** operativ reflektojnë të menaxherët për t’i vlerësuar arritjet e biznesit dhe në qoftë se nuk arrihen qëllimet e dëshiruara të bëhen ndryshimet adekuate në aktivitetin e biznesit të tyre.

Për të marrë vendimet adekuate, nga ana e menaxhmentit për planifikimin e aktiviteteve afariste dhe kontrollin e tyre, së pari duhet siguruar informacionet për shpenzimet që bëhen në aktivitetet e ndryshme afariste. Vetëm mbi bazën e këtyre informacioneve, menaxhmenti mund të përcaktojë profitabilitetin e segmenteve të ndryshme brenda ndërmarrjes.

Menaxhimi i **kostos** lidhet me përcaktimin e shpenzimeve në aktivitetet e ndryshme afariste dhe njehërit matë koston e produkteve të gatëshme.

Në teorinë dhe në praktikën kontabël, ky segment i kontabilitetit njihet me emërtimin “kontabiliteti i shpenzimeve” (kostos) dhe shumë autor e quajnë “zemra e kontabilitetit të menaxhmentit”. Menaxhimi i shpenzimeve (kostos) dhe determinimi i tyre janë komponentet kryesor në kontabilitetin e shpenzimeve. Krahas ndryshimeve të mjedisit afariste, ky segment, mjaft kompleks për ndërmarrjen, është bërë shumë i rëndësishëm, gjë që ka ndikur edhe në shtimin e përgjegjësisë së menaxhmentit për drejtim sa më efikas të tij.

Krahas shqyrtimit teorik, përdorimin e informatave të sistemit të kontabilitetit po e prezantojmë edhe nëpërmjet një skeme.

Dedikimi i informatave të fushave të kontabilitetit

Kriteriumi	Kontabiliteti i menaxhmentit	Kontabiliteti financiar

1.Përdoruesit primarë informatave	Menaxhmenti i ndërmarrjes në të gjitha nivelet e menaxhimit	Grupet eksterne: investitorët, kreditorët, partnerët afarist, sindikata, organet shtetërore si dhe menaxhmenti i ndërmarrjes
2.Liria e zgjedhjes së Strukturave të raportimit	Nuk ka kufizime të tjera, pos përmbajtjes së shpënzimeve dhe dobishëmerisë prej informatave për menaxhim	Kufizohet me parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit në standarde
3.Fokusi kohor	E drejtur kah ardhmëria: përdorimi formal i planëve dhe raporteve historike,p.sh. plani për 2008 në krahasim me realizimin për të njëjtin vit	E orientuar kah e kaluara:p.sh. rezultati financiar i vitit 2008 në krahasim me vitin 2007
4. Periudha raportuese	Fleksibile me variacione për raportet e një ore, deri të raportet për 10-15 vjetësh	Më pak fleksibile: zakonisht një vit, gjymë viti ose një kuartal
5.Influenca e informatave në marrjen e vendimeve	I kushton vëmendje të duhur vlerësimit dhe raportimit që ndikojnë në marrjen e vendimeve nga ana e menaxherit	I kushton vëmendje çmuarjes së dukurive ekonomike. Ndikimi i tyre në marrjen e vendimeve është sekundar.
6.Karakteri i raporteve	Pasqyra analitike: informata detaje për segmentet e ndërmarrjes, etj.	Pasqyra përmbledhëse: së pari kanë të bëjnë me ndërmarrjen në tërësi.
7.Përkufizimi i aktivitetit	Fusha e kontabilitetit të menaxhmentit nuk përkufizohet në mënyrë strikte	Fusha e kontabilietit financiar përkufizohet në mënyrë strikte. Nuk është në lidhmëri të madhe me shkencë tjera.

	Ka marëdhënje me shkenca të tjera ekonomike, teorine e vendosjes etj.	
--	---	--

Korniza e rregullave të kontabilitetit dhe pasqyrat financiare

Rregullat e kontabilitetit krijohen me qëllim që të përdoren në procesin kontabël dhe për përgatitjen finale të pasqyrave financiare.

Këto rregulla janë të përcaktuara në formë:

- a) të parimeve të kontabilitetit dhe
- b) të standardeve të kontabilitetit

Korniza për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave, në suaza ndërkombëtare, është pranuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) në prill të vitit 2001 edhe pse e njëjta është nxjerr për publikim në vitin 1989 nga Komiteti I (IASB) ose (BSNK).

Kjo kornizë trajton:

- a) objektivin e pasqyrave financiare
- b) karakteristikat cilësore që përcaktojnë dobishmërinë e informacionit në pasqyrat financiare
- c) përkufizimin, njohjen dhe vlerësimin e elementeve nga të cilat ndërtohen pasqyrat financiare
- d) konceptet e kapitalit dhe kapitalit të mbajtur.

Bordi I Standardeve të Kontabilitet Financiar FASB në SHBA ka zhvilluar kornizën konceptuale, e cila përfshinë brenda saj trajtimin lidhur me:

- 1) *Objektivin e raportimit financiar*
- 2) *Karakteristikat cilësore të informacionit kontabël*
- 3) *Elementet e pasqyrave financiare*

4) *Udhërrëfyesit operacional (supozimet, parimet dhe kufizimet).*

Trajtimi teorik, në vazhdim të këtij kapitulli, ndërlidhet me kornizën për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare në suaza ndërkombëtare.

Objektivi I pasqyrave financiare është ofrimi i informacionit lidhur me:

- a) gjendjen financiare
- b) rezultatin financiar
- c) ndryshimet e gjendjes financiare të një entiteti ekonomik që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike.

Pasqyrat financiare gjithashtu japin informacione edhe për përgjegjshmëinë e menaxhmentit, lidhur me menaxhimin e resurseve të një entiteti (biznesi) ekonomik janë:

- resurset ekonomike që ajo kontrollon
- struktura financiare e saj
- likuiditeti dhe aftësia e saj paguese
- mundësia e përshtatjes së ndryshimit të mjedisit ku afaron

Informacioni për **resurset ekonomike**, të cilat i kontrollon njësi ekonomike, është i dobishëm për parashikimin e aftësisë së saj për të gjeneruar mjete monetare në të ardhmen.

Informacioni për **strukturën financiare** është i dobishëm për të parashikuar nevojat për huazimet në të ardhmen dhe se si do të shpërndahet fitimi i mbajtur ndërmjet pronarëve të entitetit ekonomik në të ardhmen. Ndërsa informacioni për likuiditetin dhe aftësinë paguese është i rëndësishëm për parashikimin e aftësisë së entitetit ekonomik në përmbushje të detyrimeve në afatin e duhur.

Informacioni për **rezultatin financiar** të entitetit ekonomik është i dobishëm për t'u vlerësuar ndryshimet në resurset ekonomike që ajo kontrollon në të ardhmen dhe njëkohësisht përdoret për parashikimin e mundësisë së njësisë ekonomike për të gjeneruar rrjedha positive të keshit në të ardhmen nga resurset ekzistuese.

Informacioni për **ndryshimet në gjendjen financiare** të një entiteti ekonomik është i dobishëm për t'u vlerësuar veprimtaritë afariste, veprimtaria investuese dhe veprimtaria financiare gjatë një

periudhe të caktuar. Informacioni I tillë përdoruesve u shërben për të vlerësuar aftësitë e njësisë ekonomike për gjenerimin e rrjedhës së keshit si dhe nevojat e tij për përdorimin e këtyre rrjedhave.

- Bilanci ofron informacionin për gjendjen financiare të një entiteti.
- Pasqyrat e të ardhurave ofrojnë informacionin për rezultatin financiar të njësisë ekonomike.
- Pasqyrat e veçanta financiare sigurojnë informacionin për ndryshimet në gjendjen financiare të njësisë ekonomike.

Udhëzuesit e kontabilitetit

Udhëzuesit kryesorë operacional për zhvillimin e procesit kontabël janë: supozimet, parimet dhe kufizimet.

Emërtimet parime, supozime dhe koncepte në praktikën kontabël në të kaluarën janë përdorur si terma alternative përkatësisht si sinonime. Megjithatë definimet në vijim për udhëzuesit kontabël do të tregojnë ekzistimin e dallimeve të vogëla ndërmjet tyre.

Supozimet (Assumptios) vijnë nga mjedisi biznesor dhe ato janë krijuar nga mendimi njerëzor duke e kombinuar praktikën, traditën dhe rregullat zyrtare. Ato në fakt janë bazament I procesit të kontabilitetit.

Parimet (Principles) janë rregulla specifike të cilat përdoren në regjistrimin kontabël dhe për matjen e elementeve të pasqyrave financiare. Ato janë krijuar mbi bazën e supozimeve.

Kufizimet (Constraints) në një formë përfaqësojnë kufizimin e dobishmërisë së informacionit të dhënë në pasqyrat financiare për shkak të disa pengesave që lidhen me relacionin e kostobenefitit, materialitetin dhe konzervatizmin. Kufizimet e raportimit financiar për shkak të faktorëve të lartcekur kërkohet të merrën në konsideratë nga përdoruesit e pasqyrave financiare se përkundër asaj besueshmëria dhe plotësia e informacionit kontabël gjithmonë do të sigurohet në nivelin e duhur.

Supozimet

Supozimet janë fundament i procesit kontabël. Katër supozimet themelore të cilat përdoren në kontabilitet janë:

- *Supozimi i entitetit ekonomik*
- *Supozimi i njësisë monetare*
- *Supozimi i periudhës kohore dhe*
- *Supozimi vijimësisë (vazhdimësisë).*

Supozimi i entitetit kontabël – konsiderohet si një prej supozimeve themelore i cili kërkon që entiteti kontabël të definohet në mënyrë të qartë. Si entitet kontabël mund të jetë secila njësi ekonomike dhe individ që i kontrollon resurset e veta dhe merret me veprimtari ekonomike.

Sipas këtij supozimi ndërrimet ekonomike mund të definohen dhe regjistrohen vetëm për njësitë e veçanta të kontabilitetit. Entitete të kontabilitetit mund të jenë bizneset, agjencitë qeveritare dhe entitetet tjera joprofitabile si p.sh. shkollat, spitalet etj.

Le të supozojmë se firma “X” kur ka filluar aktivitetin e saj me biznes ka marrë një hua nga Banka Ekonomike prej 400.000 €. Mbi bazën e këtij supozimi kontabiliteti i “X” shumën prej 400.000 € të investuar në biznes e evidencon ndaras nga pasuria personale e pronarit, siç janë shtëpia , vetura dhe pasuritë e tjera personale të tij.

“Toyota” është një kompani e madhe për prodhimin e automobilave me shumë departamente të prodhimit dhe shitjes në shumë vende të botës. Menaxhmenti i “Toyotës” i vlerëson si entitete të ve të prodhimit dhe shitjes në shumë vende të botës. Menaxhmenti i “Toyotës” i vlerëson si entitete të veçanta të kontabilitetit secilin departament të saj.

Supozimi i njësisë monetare – sipas këtij supozimi në kontabilitetin financiar regjistrohen vetëm transaksionet, të cilat mund të shprehen në njësi monetare. Me fjalë të tjera, supozimi i njësisë monetare nënkupton se paraja është njësi bazike për matje të elementeve në raportimin financiar.

Prandaj, vetëm me para mund të shprehet totali i pasurisë, detyrimeve ose netofitimi i biznesit në raportimet financiare. Kështu p.sh. vlera e një drejtori efektiv i kompanisë nuk mund të shprehet në vlerë monetare, prandaj nuk regjistrohet në kontabilitet.

Supozimi i periudhës kohore – përdoruesve të informacionit kontabël u nevojiten informata aktuale dhe të krahasueshme me informatat e ndërlidhura të periudhave të ndryshme kohore.

Sipas supozimit të periudhës kohore sendërtimi i qëllimeve të raportimit financiar kërkon që jetëzgjatja e veprimtarisë së biznesit duhet të ndahet në periudha kohore artificiale. Në mënyrë që krahasueshmëria e pasqyrave financiare të jetë e thjeshtë dhe efektive periudhat kohore kryesisht janë të së njëjtës gjatësi kohore. Pasqyrat financiare mund të përgatiten për çdo periudhë kohore.

Periudhat kohore mund të jenë mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe njëvjeçare. Periudha njëvjeçare, të cilin e përdorin firmat për përgatitjen e raportimit financiar, quhet periudhë e kontabilitetit. Shumica e firmave si periudhë kontabël e përdotin vitin kalendarik 1 janar-31 dhjetor.

Supozimi i vijimësisë – sipas këtij supozimi pasqyrat financiare përgatiten normalisht se entiteti ekonomik është në kontinuitet të veprimtarisë së tij, dhe se do të vazhdojë të funksionojë edhe në të ardhmen e parashikuar. Në këtë mënyrë supozohet se entiteti ekonomik nuk e ka si synim zvogëlimin e aktivitetit të tij afarist, ose të likuidojë tërësisht veprimtarinë e vet. Në qoftë se ky synim për ndërprerjen e veprimtarisë ose kjo nevojë ekziston atëherë pasqyrat financiare duhet të përgatiten mbi një bazë tjetër dhe se ajo bazë e përdorur duhet të raportohet në informacionet shpjeguese të raportimit financiar.

Thelbi i supozimit të vijimësisë për kontabilistët kuptohet se entiteti ekonomik do të vazhdojë me aktivitetin e tij për aq kohë sa i nevojitet për të përmbushur në tërësi detyrimet akzistuese. Aplikimi i këtij supozimi është shumë i rëndësishëm dhe kritik për vetë ekzistencën e biznesit. Njëkohësisht implementimi i këtij supozimi e bënë kredibil përdorimin e parimit të kostos.

Në qoftë se ky supozim nuk përdoret atëherë pasurinë afatgjatë duhet raportuar në bilanc me vlerën e likuidimit (netovlerën e realizueshme) dhe jo me kostot e tyre. Në rrethanat e tilla shpenzimet e zhvlerësimit janë të panevojshme sikur që është i panevojshëm edhe klasifikimi i pasurisë në pasuri afatgjatë dhe afatshkurtër. Në qoftë se supozohet likuidimi i firmës atëherë është më mirë që elementet e pasurisë të raportohen me vlerën likuiduese sesa me koston e tyre.

Parimet e kontabilitetit

Parimet e kontabilitetit janë rregulla specifike të cilat tregojnë se si duhet të regjistrohen transaksionet financiare dhe si maten te elementet e raportuara në pasqyrat financiare. Mbi bazën e supozimeve profesioni kontabël ka zhvilluar rregulla të regjistrimit kontabël të quajtura parime.

Parimi i kostos

Parimi i koston kërkon që pasuria e blerë dhe detyrimet, në datën e blerjes, duhet të regjistrohet me koston fillestare, përkatësisht me koston aktuale të tyre. Ky parim e justifikon koston fillestare gjegjësisht koston historike për faktin se konceptualisht kostoja dhe vlera fer e pasurisë janë të barabarta në datën e blerjes.

Regjistrimi i pasurisë me kosto vlerësohet si matje e besueshme dhe relevante. Kostoja është e besueshme sepse ajo objektivisht matet pa vështirësi, përcillet me fakte dhe është e vërtetueshme. Ndërsa kostoja është relevante sepse ajo paraqet në mënyrë të qartë çmimin e paguar (vlerën e blerë dhe shpenzimet tjera) në datën e blerjes.

Sipas këtij parimi pasuria e regjistruar në kontabilitet mbahet me koston historike gjatë tërë jetëzgjatjes së saj. Në qoftë se kemi të bëjmë me pasurinë afatgjatë ajo në fund të çdo periudhe kontabël raportohet me koston historike të zvogëluar për shpenzimet e zhvlerësimit ose shpenzimet e amortizimit. Respektimin e parimit të koston po e ilustruam me shembullin në vijim:

Le të supozojmë se ka falimentuar një firmë prodhuese në Prishtinë dhe në datën e falimentimit ju keni blerë për firmën tuaj pajime në vlerë prej 7.000 €. Ju pretendoni se vlera reale e pajimeve është 90.000 €. Sipas parimit të koston ju duhet të regjistroni në firmën tuaj pajimet me koston fillestare prej 7.000 €.

Parimi i realizimit (njohjes së të hyrave)

Parimi i realizimit siguron udhëzimet për kriteret mbi bazën e të cilave duhet të njihen të hyrat e një periudhe kontabël. Sipas këtij parimi kryesisht të hyrat duhet të njihen dhe raportohen në pasqyrat e të ardhurave në atë periudhë kontabël në të cilën janë përfituar. Parimi i realizimit thekson se të hyrat

duhet të njihen dhe raportohen në pasqyrën e të ardhurave kur plotësohen paraprakisht kushtet në vijim:

- 1) *Kur koha dhe shuma e të hyrave është e përcaktuar me dëshmi objektive dhe në mënyrë të arsyeshme.*
- 2) *Procesi i përfitimit të të hyrave është kompletuar në tërësi.*

Ekzistojnë katër kritere, lidhur me njohjen e të hyrave, të cilat janë objekt i studimit të kontabilitetit të avancuar. Përgjithësisht, në të shumtën e rasteve, sipas parimit të realizimit të hyrat duhet të njihen në momentin e shitjes së mallrave dhe shërbimeve.

Parimi i shkakësisë (i njohjes së shpenzimeve)

Parimi i shkakësisë në thelb është i lidhur me njohjen e shpenzimeve. Sipas parimit të shkakësisë të hyrat e gjeneruara dhe shpenzimet e ndodhura për përfitimin e këtyre të hyrave duhet të raportohen në pasqyrën e të ardhurave në të njëjtën periudhë kontabël.

Të hyrat gjatë një periudhe kontabël njihen mbi bazën e parimit të realizimit. Ndërsa shpenzimet e ndodhura për gjenerimin e këtyre të hyrave njihen në pajtueshmëri me parimin e shkakësisë. Për këtë arsye shpenzimet janë raportuar në pasqyrën e të ardhurave për periudhën kontabël, duke i ballafaquar ato me të hyrat të cilat janë njohur në të njëjtën periudhë.

Ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave ekziston lidhje shkak-efekt. Shpenzimet në këtë rast janë element që shkakton krijimin e të hyrave. Prandaj në kontabilitetin akrual, matja e fitimit të periudhës kontabël bëhet duke i ballafaquar të hyrat e njohura të periudhës me shpenzimet e ndodhura të cilat kanë shkaktuar përfitimin e të hyrave të njohura gjatë periudhës së njëjtë kontabël.

Parimi i publikimit të plotë

Parimi i publikimit të plotë të raportimit financiar konsiston në atë se të gjitha elementet e rëndësishëm, të cilat ndikojnë në gjendjen financiare dhe rezultain financiar të firmës, duhet raportuar

në pasqyrat financiare ose si njoftime shtesë në mënyrë që përdoruesi i informacionit kontabël t'i ketë ato në dispozicion. Vetëm publikimi i plotë i raportimit financiar do të jetë i dobishëm për përdoruesit dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohen gabimet në interpretimin e tij.

Krahas informacioneve të rëndësishme, të cilat ndikojnë në gjendjen financiare dhe në rezultatin financiar në njoftimet shtesë të raportimit financiar, duhet të publikohen në formë të përmbledhur:

- 1) *Metodat e kontabilitetit të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare*
- 2) *Informacionet shpjeguese rreth rreziqeve dhe pasigurive që ndikojnë në njësinë ekonomike*
- 3) *Informacionet për ndojnë resurs dhe detyrim që nuk është i njohur në bilanc (p.sh. rezervat minnerale)*
- 4) *Informacion për segmentet gjeografike dhe industriale dhe efektet e tyre në ndryshimet e çmimeve të firmës etj.*

Parimi besueshmërisë (objektivitetit)

Informacionet e kontabilitetit janë të bazuara në shumë të dhëna objektive, të cilat firma i ka në dispozicion. Termi i besueshëm ose objektiv i referohet matjeve neutrale dhe të vërtetuara të informacionit kontabël nga ekspertët e pavarur (auditorët).

Shumat e çmimeve, që rezultojnë në transaksionin e blerjës dhe shitjes së mallrave, regjistrohen në kontabilitet mbi bazën e dëshmive objektive siç janë p.sh. faturat, marrëveshjet tregtare, instrumentet e çekut, inventarizimi fizik i mallit etj

Mbi bazën e këtij parimi kontabilistët janë të përkushtuar që matjet e elementeve të pasqyrave financiare të jenë të besueshme dhe njëkohësisht të rëndësishme për marrjen e vendimeve nga përdoruesit e tyre.

Kufizimet (Constraints)

Kufizimet e raportimit financiar në një mënyrë i nxisin firmat që të modifikojnë parimet e përgjithshme me qëllim që të mos zvogëlohet dobishmëria e informacionit kontabël për përdoruesit e tij. Kufizimet e informacionit kontabël rezultojnë kryesisht prej analizës së kostobenefitit, përshtatshmërisë në kohë të informacionit, materialitetit, konzervatizimit etj. Informacioni kontabël është resurs, prandaj si çdo pasuri tjetër edhe ai posedon kosto. Në qoftë se kostot tejkalojnë benefitet e përdorimit të tij nuk do të kishte vlerë praktike gjenerimi i informacionit kontabël.

Përshtatshmëria në kohë është faktor i cili ndikon në kufizimet e përdorimit të informacionit kontabël. Në qoftë se ka një vonesë të pajustificuar, në raportimin e informacionit, ai në këtë rast mund të humbë dobinë dhe përkatësinë e tij edhe në qoftë se është plotësisht i besueshëm. Kufizimet në dobishmërinë e informacionit kontabël zvogëlohen dukshëm kur ai raportohet në kohën e duhur.

Materialitetit është një faktor me peshë specifike në kufizimet e raportimit financiar sepse informacioni material ulë dobishmërinë e informacionit kontabël dhe ndikon në marrjen e vendimeve tek përdoruesit e informacionit kontabël. Informacioni kontabël është material në qoftë se shumat e elementeve të raportuara në pasqyrat financiare janë të shtrembuara ose kanë anomali të tjera dhe të njëjtat ndikojnë marrjen e vendimeve të arsyeshme nga përdoruesit e tij. Me fjalë të tjera informacioni material nënkupton informacionin më gabime materiale, qofshin ato të qëllimshme ose jo të qëllimshme, i cili ndikon në marrjen e vendimeve të drejta nga investitorët, kreditorët etj. Informacioni jomaterial nuk ndikon në marrjen e vendimeve nga përdoruesit e tij. Efektet financiare, të informacionit kontabël, kontabilistët i përcaktojnë në bazë të raportit ndërmjet shumës së elementit material ndaj totalit të pasurisë, totalit të detyrimeve dhe fitimit neto.

Konservatizmi siguron udhëzime për kontabilistët, lidhur me gjykimet dhe vlerësimet që duhet bërë, kur ata kanë të bëjnë me situata të vështira dhe të paqarta. Kur dy ose më shumë alternativat të kontabilitetit janë të mundshme për të sendërtuara në mënyrë të barabartë, atëherë sipas konservatizmit duhet zgjedhur alternativën e cila ka ndikim më të vogël në fitimin neto të periudhës.

Praktikisht konservatizmi nënkupton se në stuatën me dy ose më shumë alternativa të kontabilitetit duhet zgjedhur alternativën e cila ndikon më pak, në mbivlerësimin e pasurisë dhe mbivlerësimin e fitimit neto. Sipas konservatizmit gjykimet dhe vlerësimet për rrezikun e mundshëm të biznesit, në periudhat e ardhshme, duhet vlerësuar në nivele adekuate. Një shembull praktik i

përdorimit të konservatizmit është përdorimi i metodës më të ultë se kostoja ose me vlerën e tregut në vlerësimin e inventarit.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

Karakteristikat cilësore janë tipare që e bëjnë të dobishëm për përdoruesit e informacionin e dhënë në pasqyrat financiare. Sipas SNK-ve katër karakteristikat cilësore kryesore janë:

- a) **Kuptueshmëria**
- b) **Përkatësia**
- c) **Besueshmëria dhe**
- d) **krahasueshmëria**

Kuptueshmëria është cilësia bazë e informacionit të dhënë në pasqyrat financiare. Në këtë drejtim supozohet se përdoruesit e informacionit të raportimit financiar kanë njohuri të arsyeshme për veprimtarinë e biznesit dhe kontabilitetit, prandaj ata me kujdes i lexojnë dhe studiojnë të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare. Kuptueshmëria, si cilësi kryesore e informacionit kontabël, nuk nënkupton se të dhënat për segmente komplekse të biznesit, që vështirë kuptohen, duhet përjashtuar nga raportimi financiar sepse vetëm informacioni i plotë shërben si bazë për marrjen e vendimeve racionale nga përdoruesit e informacionit kontabël.

Përkatësia e informacionit kontabël është gjithashtu një veti e rëndësishme, e cila e bën informacionin kontabël të dobishëm për përdoruesit e tij. Informacioni posedon cilësinë e përkatësisë në qoftë se ai i ndihmon përdoruesit në marrjen e vendimeve të drejta lidhur me ngjarjet e shkuara, të tashme dhe të ardhshme të biznesit. P.sh. në qoftë se investitorët e ndryshëm kanë në zotërim aksionet e një firme. Ata mbi bazën e strukturës së pasurisë dhe në bazë të fitimit të raportuar në pasqyrën e të ardhurave, do të mësojnë mbi aftësinë e firmës për pagesat e dividendit, për lëvizjen e çmimit të aksioneve në të ardhmën etj. Në këtë rast p.sh. të hyrat operative të raportuara në pasqyrën e të ardhurave janë përkatëse në qoftë se në kategorinë e tyre nuk janë përfshirë kategori të të hyrave të jashtëzakonshme. Të hyrat e jashtëzakonshme duhet të raportohen në kategorinë e tyre përkatëse me të njëjtin emërtim.

Natyra dhe materialiteti i informacionit kontabël ndikon në masë të madhe në përkatësinë e informacionit kontabël. Ndonjëherë vetëm natyra e informacionit shpreh përkatësinë e tij. P.sh.

raportimi i një segmenti të ri në pasqyrat financiare do t'u mundësojë përdoruesve të vlerësojnë rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballet firma në të ardhmen. Një informacion kontabël është material në qoftë se shtrembërimet e tij ndikojnë në marrjen e vendimeve të përdoruesve.

Besueshmëria, si karakteristikë cilësore e informacionit kontabël, konsiston në atë se kur informacioni kontabël është pa gabime dhe shtrembërimet, përdoruesit mund ta përdorin në marrjen e vendimeve sepse raporton me besnikëri atë të cilën ka synuar ta paraqesë.

Që të jetë i besueshëm informacioni kontabël duhet të paraqesë me besnikëri të gjitha transaksionet e ndodhura. P.sh. në bilanc duhet të paraqiten të gjitha kategoritë e pasurisë, kapitalit të vet dhe detyrimeve të cilat janë njohur në datën e përgatitjes së tij. Në qoftë se pasqyrat financiare duhet të paraqesin besnikëri të gjitha transaksionet e firmës, atëherë është e nevojshme që ato të paraqiten në harmoni me përmbajtjen e tyre, përkatësisht me realitetin e tyre ekonomik dhe jo vetëm sipas formës ligjore.

Që të jetë i besueshëm informacioni, i dhënë në pasqyrat financiare, duhet të jetë neutral pa shtrembërimet dhe i përgatitur me kujdes duke i vlerësuar në mënyrë të arsyeshme pasiguritë dhe rreziqet të cilat mund ta përcjellin biznesin. Gjithashtu edhe paraqitja e plotë e informacionit kontabël brenda kufijve të materialitetit e bën atë të besueshëm.

Krahasueshmëria, si cilësi e rëndësishme e informacionit kontabël, u mundëson përdoruesve të vlerësojnë tendencat në gjendjen financiare dhe rezultatin e firmës. Përdoruesit gjithashtu duhet të kenë mundësi të krahasojnë pasqyrat financiare të firmave në mënyrë që vlerësojnë ndryshime relative në gjendjen financiare dhe rezultatin ekonomik të tyre.

Për t'u bërë në mënyrë sa më efektive krahasueshmëria e pasqyrave financiare të firmës gjatë viteve të ndryshme ose krahasueshmëria me pasqyrat financiare të firmave të tjera, informacioni i raportimit financiar duhet të përcillet me njoftime lidhur me politikat kontabël të përdorura në ndërtimin e pasqyrave financiare. Krahasueshmëria e pasqyrave financiare të një firmave nëpër vite të ndryshme varet nga konsiztenca (qëndrueshmëria) e metodave të kontabilitetit, të përdorura në përgatitjen e tyre. Kjo nënkupton se metodat e kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare nuk duhet të ndërrohen nga viti në vit, pa ndonjë arsye të madhe.

PASQYRAT FINANCIARE

BILANCI I GJENDJES

Kontabiliteti proceson (përpunon) informacione të cilat emërtohen si pasqyra financiare. Nëpërmjet këtyre informacioneve biznesi komunikon me publikun. Në këtë drejtim, një prej pasqyrave fundamentale të raportimit financiar është bilanci i gjendjes.

Bilanci raporton në formë të përmbledhur gjendjet (saldot) e llogarive të pasurisë, kapitalit të vet dhe detyrimeve të biznesit në datën e ndërtimit të tij për një periudhë të caktuar kohore. Data e ndërtimit të bilancit zakonisht është fundi i periudhës fiskale, por ndërmarrjet e mëdha e përpilojnë atë edhe në periudhat njëmujore, tremujore, gjashtëmujore etj.

Bilanci ndryshe emërtohet pasqyrë e pozitës financiare, përkatësisht pasqyrë e gjendjes financiare. Emërtimi bilanc vjen nga presupozimi se ndërmjet totalit të pasurisë, në njërin anë dhe totalit të kapitalit dhe detyrimeve, në anën tjetër, duhet të ekzistojë një gjendje e baraspeshuar. Me fjalë të tjera, totali i pasurisë në bilanc duhet të jetë i barabartë me totalin e kapitalit të vet dhe detyrimeve. Kjo baraspeshë e këtyre dy anëve mund të shprehet me anë të ekuacionit në vijim:

$$\text{Pasuria} = \text{Kapitali i vet (Ekuiti)} + \text{Detyrimet}$$

Ky ekuacion, në fakt, quhet ekuacion themelor i bilancit. Në qoftë se u referohemi elementeve të përfshira në ekuacionin e bilancit, atëherë rrjedh se nëpërmjet tij raportohen të matura: *pasuria, kapitali i vet (pronarit) dhe detyrimet* e biznesit.

Këto tri koncepte përfaqësojnë edhe pjesët kryesore të bilancit. Prezantimi i këtyre elementeve, në mënyrë korrekte dhe me bësueshmëri maksimale, e bëjnë bilancin të jetë fotografia më besnike e pozitës financiare të firmës.

Bilanci, si pasqyrë financiare, për ndërmarrjen dhe të interesuarit e jashtëm të saj, përfaqëson burimin primar të informacionit për likuiditetin fleksibilitetin financiar të firmës. Për këtë arsye tri elementet kryesore të tij siç janë: pasuria, kapitali i vet dhe detyrimet, në këtë pasqyrë duhet të raportohen të klasifikuara me klasa të veqanta, më mënyrë që përdoruesit e tij të kuptojnë me lehtësi

situatën financiare të firmës. Kështu p.sh. pasuria afagjatë është më pak likuide në krahasim me pasurinë afatshkurtër, prandaj ato në bilanc raportohen në ketegari të veqanta. Gjithashtu edhe detyrimet afatshkurtra në krahasim me detyrimet afatgjata e kanë afatin e maturimit (përmbushjen e detyrimeve ndaj tyre) më të shkurtër, prandaj raportohen në bilanc në kategori të veqanta.

Konform SNK-ve rënditja e pasurisë në bilanc raportohet sipas rritjës së likuiditetit. Kjo praktikisht nënkupton se pasuria, e cila ishte më së paku likuide, raportohet e para dhe pas rritjës së likuiditetit rënditen kategorit tjera të pasurisë. Ndërsa rënditja e detyrimeve bëhet sipas maturimit të tyre. Fillimisht raportohen me maturimin më të gjatë dhe pastaj rënditja bëhet sipas zvogëlimit të maturimit të tyre.

Ekzistojnë dy formate, përkatësisht dy modele, të cilat zakonisht përdoren për prezantimin e bilancit.

- a) *Formati vertikal ose në formë raportit*
- b) *Formati horizontal ose në formë të llogarisë T*

Formati vertikal, për përgatitjen e bilancit, kryesisht përdoret në praktikë, kurse formati horizontal përdoret në studime sepse kuptohet më lehtë nga individët që merrën me studimin e kontabilitetit. Bilanci identifikohet me cilësitë specifike të tij, të cilat i duhet t'i përmbajë kjo pasqyrë sikur në vijim:

- a) *Emri i entitetit për të cilin përgatitet bilanci*
- b) *Emri i pasqyrës financiare si bilanc*
- c) *Data e përpilimit të bilancit*
- d) *Njësia monetare, në të cilën janë matur kategoritë e tij*

Ilustrimin e formatit vertikal dhe horizontal të përgatitjes së bilancit po e prezantojmë nëpërmjet shembullit në vijim:

Shembull:

Le të supozojmë se firma “Elkos” më 31.12.2007 ka pasur këtë saldo (tepëricë) në llogaritë e librit kryesor: ndërtesat 700.000 \$, makineritë 200.000 \$, pajisjet 100.000 \$, inventari i mallit 100.000 \$, blerësit (llogaritë e arkëtushme) 80.000 \$, parapagimet 20.000 \$, keshi 100.000 \$, kapitali i

kontribuar 900.000\$, krediti afatgjatë i pagushëm 200.000 \$, furnitorët (llogaritë e pagushme) 120.000 \$, tatimi në fitim i pagushëm 60.000 \$ pagat e pagushme 20.000 \$.

Elkos”**Bilanci me 31 dhjetor 2007****Pasuria**

Ndërtesat	700.000
Makineritë	200.000
Pajisjet	<u>100.000</u>
Totali i pasurisë afatgjatë	1.000.000
Iventari i mallit	100.000
Llogaritë e arkëtushme (blerësit)	80.000
Parapagimet e qirasë	20.000
Keshi	<u>100.000</u>
Totali i pasurisë afatshturtër	<u>300.000</u>
Totali i pasurisë	<u>1.300.000</u>
Kapitali i vet dhe detyrimet	
Kapitali i vet	<u>900.000</u>
Totali i kapitalit të vet	900.000
Detyrimet afatgjata	
Kreditit afatgjatë i pagushëm	200.000
Totali i detyrimeve afatgjata	200.000
Llogaritë e pagushme (furnitorët)	120.000
Tatimi në fitim i pagushëm	60.000
Pagat e pagushme	20.000

Totali i detyrimeve afatshkurtra	<u>200.000</u>
Totali i detyrimeve	<u>400.000</u>
Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve	1.300.000

Formati horizontal i bilancit

“Elkos”			
Pasuria		Kapitali i vet dhe detyrimet	
Bilanci 31.12.2007			
Emërtimi i llogarive	Shuma	Emërtimi i llogarive	Shuma
Ndërtesat	700.000	Kapitali i vet	900.000
Makineritë	200.000	Kreditit afatgjat i pagushëm	200.000
Pajisjet	100.000	Llogaritë e pagushme	120.000
Inventari i mallit	100.000	Tatimi në fitim i pagushëm	60.000
Llogaritë e arkëtushme	80.000	Pagat e pagushme	20.000
Parapagimet e qirasë	20.000		
Keshi	100.000		
	<hr/>	Totali i kapitalit të vet dhe	
Totali i pasurisë	1.300.000	detyrimeve	1.300.000

Klasifikimi i bilancit

Pasuri e ndërmarrjes janë resurset ekonomike të kontrolluara nga ndërmarrja, të krijuara nga transaksionet e ndodhura në të kaluarën dhe prej të cilave ajo pret të krijojë benefite (dobi) në të ardhmen. Roli i pasurisë për biznesin po e ilustruam me një shembull:

Binesi tregtar “Elkos” blen mallra nëpër shtete të ndryshme. Këto mallra të blera “Elkos” pastaj ua shet blerësve të ndryshëm, qoftë bizneseve tregtare të pakicës spo konsumatorëve finalë. Për ta realizuar shitjen, “Elkos” përdor objektet e veta si pika të shitjes apo pajime të ndryshme për ta dërguar

mallin të blerësi. Nëpërmjet pasurisë së vetë “Elkos” zhvillon aktivitetin e saj afarist me qëllim që të gjenerojë fitim.

Pasuria ndahet në dy lloje kryesore:

- *Pasuri afatgjatë (jokorente)*
- *Pasuri afatshkurtër (korente)*

Pasuria afatgjatë mbahet për t’u përdorur nga biznesi në aktivitetin operativ të tij dhe se afatin e përdorimit (maturimit) e ka më të gjatë se një vit. Llojet kryesore të pasurisë afatgjatë janë:

- *Patundshmëritë, impiantet dhe pajimet*
- *Pasuria e paprekshme*
- *Investimet financiare dhe fondet për qëllime speciale*

Patundshmëritë, impiantet dhe pajimet janë në formë fizike, mund të preken, shihen dhe maten fizikisht. Ky grup i pasurisë është destinuar për aktivitetin operativ të biznesit. Me fjalë të tjera, është fundament i aktivitetit afarist të tij. Ndryshe, pasuritë e tilla emërtohen edhe si pasuri fikse.

Pasuritë e paprekshme, ngjashëm me patundshmëritë, impiantet dhe pajimet janë pasuri afatgjatë dhe nga ato biznesi pret të ketë dobi në të ardhmen. Ky lloj i pasurisë është në formë të të drejtave dhe nuk kanë substancë fizike. Shembuj të pasurisë së paprekshme janë: *patenta, licenca, franshiza, goodvilli, shenja tregtare* etj. Kostoja fillestare e tyre evidentohet ngjashëm me pasuritë fikse, por procesi i alokimit të kostos fillestare në shpenzime të periudhës quhet amortizim, përderisa ky proces kur është në pyetje pasuria fikse emërtohet si zhvlerësim.

Investimet financiare dhe fondet për qëllime speciale janë pasuri jooperacionale (joafariste). Kur firmat blejnë letra me vlerë të kompanive të tjera në këtë rast investimet e tilla trajtohen si pasuri afatgjatë në qoftë se ajo pretendon ato t’i mbajë në periudhë më të gjatë se një vit me qëllim të përfitimit të dobive në të ardhmen.

Pasuria afatshkurtër (korente)

Në pasurinë afatshkurtër përfshihet keshi dhe pasuria tjetër, e cila pritet të shëndrrohet në kesh ose konsumohet brenda një viti apo në suaza të ciklit normal operues.

Për faqësuesit kryesorë të pasurisë afatshkurtër janë: inventari i mallit , blerësit (llogaritë e arkëtushme), parapagimet e shpenzimeve, investimet financiare afatshkurta etj.

Inventari i mallit (rezervat) te ndërmarrjet tregtare janë pasuri afatshkurtër në substancë fizike, të cilat blihen me qëllim për tu rishitur. Ndëesa te ndërmarrjet prodhuese inventarët prodhohen në aktivitetin e rregullt afarist të firmës me qëllim që pastaj ato t'u shitën blerësve. Inventari i ndërmarrjeve prodhuese përbëhet prej: lëndes së parë, prodhimit në proces (prodhimit të pa kryer) dhe produkteve të gatshme.

Blerësit (llogaritë e arkëtushme) rezultojnë nga shitjet e mallrave ose shërbimeve me afatpagese (kredit).

Parapagimet e shpenzimeve të përfshira brenda pasurisë afatshkurtër janë shpenzime të këmbjera, për dobitë që do të përfitohen në formë të shërbimeve brenda një viti ose gjatë një cikli normal operativ.

Investimet afatshkurtër janë pasuri shumë likuide, të cilat përfshihen në pasurinë afatshkurtër. Pasuri likuide janë resurset të cilat mund të shëndrrohen në kesh brenda një periudhe relativisht të shkurtër. Në investimet afatshkurtëra përfshihen investimet e tregtushme, investimet në dispozicion për shitje në qoftë se pretendohet të shiten brenda një viti dhe investimet për t'u mbajtur deri në maturim, në vitin e fundit të maturimit të tyre.

Keshi është një prej kategorive më të rëndësishme brenda pasurisë afatshkurtër. Keshi, si kategori, përfshinë keshin në dorë dhe keshin e depozitur në bankë. Ekuivalentet e keshit janë letrat me vlrë afatshkurtër me afat maturimi tre muaj të cilat në çdo kohë mund të shëndrrohen në kesh. Ekuivalentët e keshit në bilanc raportohen të kombinuara me keshin.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përfaqëson të drejtat e pronarëve në pasurinë e korporatës. Në fakt kërkesat e pronarëve, ndaj pasurisë së ndërmarrjes, janë të barabarta me shumën e pasurisë e cila mbetet pasi të zbriten të gjitha detyrimet.

Tek bizneset inokose (individuale) kapitali i pronarit evidentohet në një llogari të veçantë të quajtur kapitali i vet (i pronarit). Bizneset partnere (ortake) janë në pronësi të disa pronarëve, prandaj kapitali i secilit pronar në bilanc raportohet në formë të veçantë. Për dallim nga bizneset inokose dhe ato partnere, kapitali i pronarëve të korporatës quhet kapital aksionar dhe si i tillë ai konsiderohet shumë më kompleks.

Kapitali aksionar përbëhet prej dy kategorive:

- a) ***Kapitali i kontribuar (fillestar) dhe***
- b) ***Fitimi i mbajtur***

Këto dy kategori të kapitalit aksionar në esencë janë dy burimet ose kërkesat ndaj pasurisë së korporatës.

Kapitali i kontribuar përfaqëson shumën e investuar nga pronarët e korporatës. Saldo e llogarisë së kapitalit aksionar, e raportuar në bilancin e gjendjes, është në fakt saldo përfundimtare e kësaj llogarie e raportuar në pasqyren e kapitalit aksionar. Normalisht kjo saldo përfshin shumën e grumbulluar të kapitalit të kontribuar dhe fitimit të mbajtur, të krijuar nga korporata gjatë viteve të aktivitetit të saj.

Fitimi i mbajtur, si element i kapitalit aksionar, raportohet në bilanc me shumën për të cilën netofitimi tejkalon shpërndarjet e dividendit për aksion. Fitimi i mbajtur si llogari përdoret për të regjistruar netofitimin ose netohumbjen dhe shpërndarjen e dividendit.

Detyrimet afatgjata (jo korente) janë obligime të ndërmarrjes të cilat e kanë maturimin , gjegjësisht afatin e pagesës ndaj tyre më të gjatë se një vit.

Kategoritë kryesore të detyrimeve afatgjata janë: ***obligacionet e pagushme, krediti afatgjatë i pagushëm, detyrimet ndaj qirasë kapitale, tatimi i shtyrë, detyrimet ndaj pensioneve etj.*** Këto elemente përfaqësojnë një segment të rëndësishëm të financimit afatgjatë të ndërmarrjes. Kushtet e pagesës së detyrimeve afatgjata që lidhen: me kryegjënë (principalin), pagesat e kamatës, konvertimin, kushtet e huazimit kanë ndikim të rëndësishëm në rrjedhat operative të ndërmarrjes në të ardhmen, prandaj ato duhet të publikohen në bilanc.

Detyrimet afatshkurtra (rrjedhëse) janë obligimet të cilat duhet të paguhen mbrenda një viti pas një cikli normal operativ (afarist) normalisht se cila periudhë është më e gjatë. Këto detyrime kryesisht përmbushen prej pasurisë afatshkurtër ose nëpërmjet detyrimeve të reja afatshkurtra.

Në detyrimet afatshkurtër përfshihen: *dëftesat e premtushme afatshkurtra, llogaritë e pagushme (furnitorët), detyrimet e shtyra, tatimi i pagushëm, pagat e pagushme, kamata e pagushme, të hyrat e shtyra etj.*

Dëftesat e premtueshme të pagueshme reprezentojnë shumat, të cilat firma në bazë të një nënshkrimi premtues duhet t'i paguajë brenda një viti paratë e huazuara ose blerjet e mallrave me afat pagese.

Llogaritë e pagueshme (furnitorët) përfaqësojnë shumën të cilën firma duhet ta paguajë në bazë të marrëveshjes gojore ose premtimi të nënkuptuar për mallrat e blera me afatpagesë (kredit). Blerja e mallrave me afatpagese emërtohet ndryshme edhe blerje me llogari.

Detyrimet e shtyra janë shpenzimet të cilat kanë ndodhur, kurse pagesat ndaj tyre akoma nuk janë bërë. Brenda detyrimeve të shtyra përfshihen *pagat e pagushme, tatimet e pagushme, kamatat e pagushme etj.* Të hyrat e shtyra janë arkëtimet ose avanset e marura në kesh për të hyrat, të cilat do të ndodhin në periudhat e mëvonshme.

Ndikimi i transaksioneve në ekuacionin e bilancit

Bilanci në vazhdimësi ndikohet nga ndodhja e ngjarjeve, përkatësisht transaksioneve ekonomike në biznes. Ndikimin e transaksioneve në ekuacionin e bilancit po e prezantojmë me shembullin në vijim:

Shembull:

Transaksioni 1. Investimet fillestare në biznes

Le të supozojmë se Astrit Shala nga Peja, duke u bazuar në profesionin e tij si ekonomist, ka marrë vendim të fillojë një biznes tregtar për shitje të lëngjeve. Astriti ka në dispozicion 20.000 € para të veta, por kjo shumë nuk i mjafton atij për të atartuar biznesin. Mbi bazën e projektit investues atij

i nevojiten edhe 80.000 € financim shtesë. Banka Ekonomike, pasin që analizon projektin e firmës së tij, i lejon një kredi në shumë prej 80.000 € me maturim një vit. Me këtë shumë të parave Astriti blen për 80.000 € dy lokale, nga të cilat njërin do ta përdorë për zyrë, kurse tjetrin lokal të shitjes. Biznesi e fillon punën më 1 nëntor 2007 me emrin Firma “Shala”. Në këtë datë bilanci fillestar duket sikur në vijim:

Firma “Shala” më 1 nëntor 2007				
Bilanci				
	Pasuria		Kapitali i vet dhe detyrimet	
€	Ndërtesat	80.000 €	Kapitali i vet	20.000
€	Keshi	20.000 €	Dëftesat e pagueshme	80.000
	Totali i pasurisë	100.000 €	Totali i kapitalit të vet dhe detyrimet	
	100.000 €			

Efektet e transaksionit të parë në ekuacionin e bilancit janë si vijon:

Pasuria	=	Kapitali i vet	+	Detyrimet
Ndërtesat + Keshi		Kapitali i vet + Dëftesat e pagueshme		
$\underbrace{80.000€ \quad 20.000€}_{100.000 €}$		$\underbrace{20.000 € \quad 80.000 €}_{100.000 €}$		

Transaksioni 2. Blerja e inventarit të mallit me afat pagese

Më 5 nëntor firma “Shala” ka blerë lëngje prej firmës “Fruti” të prizrenit në vlerë prej 10.000€ me afat pagese dy muaj. Ky transaksion ka ndikuar në rritjen e pasurisë dhe në rritjen e detyrimeve të

firmës “Shala”. Lëngjet e blera janë inventar i mallit dhe përfshihen në pasurinë e firmës “Shala”, ndërsa blerjet e lëngjeve me afat pagese krijojnë një detyrim të ri për firmën “Shala”, i cili quhet llogari e pagueshme (furnitorët). Efektet e këtij transaksioni në ekuacionin e bilancit të gjendjes janë sikur në vijim:

Pasuria	=	Kapitali i vet	+	Detyrimet
Ndërtesat + Keshi + Inventari		Kap. I vet + Dëftesat e pagueshme + Llog. e pagueshme		
80.000€ 20.000€ + 10.000€		20.000 €		80.000 € + 10.000 €
110.000 €		110.000 €		

Transaksioni 3. Shitjet e inventarit të mallit në kesh

Më 15 nëntor firma “Shala” ka shitur lëngje në kesh në vlerë prej 5.000 €. Nga shitjet e lëngjeve firma “Shala” ka përfituar të hyra prej shitjeve të cilat e rritin kapitalin e pronarit “Shala”. Këto shitje janë bërë në kesh dhe meqenëse keshi kategori e pasurisë atëherë ky transaksion ndikon edhe në rritjen e pasurisë. Efektet në ekuacionin e bilancit janë si në vijim:

Pasuria	=	Kapitali i vet	+	Detyrimet
Ndërtesat + Keshi + Inventari		Kap. I vet + Dëftesat e pagueshme + Llog. e pagueshme		
80.000€ 20.000€ 10.000€		20.000€		80.000€ 10.000€
+ 5.000€ - 5.000€		110.000 €		
110.000 €		110.000 €		

Transaksioni 4. Pagesa e këstit të dëftesës së pagushmë (kreditit)

Më 1 dhjetor biznesi e ka paguar këstin e parë të kreditit afatshkurtër ndaj Bankës Ekonomike në vlerë prej 8.500 €. Pagesa e këstit të kreditit ka ndikuar në zvogëlimin e detyrimeve të biznesit. Meqenëse pagesa e këstit të kredisë është bërë në kesh, ky transaksion ka ndikuar edhe në zvogëlimin e pasurisë së biznesit. Efektet në ekuacionin e bilancit janë si në vijim:

Pasuria	=	Kapitali i vet	+	Detyrimet
Ndërtesat + Keshi + Inventari		Kap. I vet + Dëftesat e pagueshme + Llog. e pagueshme		
80.000€ 20.000€ 10.000€		20.000€	80.000€	10.000€
+ 5.000€ - 5.000€			- 8.500€	
-8.500€			}	
101.500 €			101.500 €	

Transaksioni 5. Blerjet e inventarit të mallit në kesh

Më 3 dhjetor biznesi “Shala” ka blerë lëngje në kesh nga një firmë e Sllovenisë në vlerë prej 7.000€. Prej këtij transaksioni është rritur inventari i mallit, si kategori e pasurisë, dhe në të njëjten kohë është zvogëluar një tjetër kategori e pasurisë sepse blerja e inventarit të mallit është bërë në kesh dhe i njëjti është kategori e pasurisë. Efektet e transaksionit në ekuacionin e bilancit janë si në vijim:

Pasuria	=	Kapitali i vet	+	Detyrimet
Ndërtesat + Keshi + Inventari		Kap. I vet + Dëftesat e pagueshme + Llog. e pagueshme		
80.000€ 20.000€ 10.000€		20.000€	80.000€	10.000€
+ 5.000€ - 5.000€			- 8.500€	
-8.500€ + 7.000€				
- 7.000€			}	
101.500 €			101.500 €	

Transaksioni 6. Pagesa ndaj llogarisë së pagueshme (furnitorëve)

Më 5 dhjetor biznesi “Shala” ka paguar detyrimin ndaj furnitorit “Fruti” në vlerë prej 9.000 € nëpërmjet një dëftese të pagueshme (kreditit afatshkurtër) të marrë nga Banka për Biznes.

Ky transaksion ka ndikuar në zvogëlimin e një shume të detyrimeve, përkatësisht të llogarive të pagueshme, por meqenëse pagesa ndaj tyre është bërë nëpërmjet dëftesës së pagueshme në të njëjten koë janë krijuar detyrime të reja, përkatësisht janë rritur detyrimet e biznesit “Shala”. Me fjalë të tjera borxhi ndaj biznesit “Fruti” është paguar nëpërmjet borxhit të ri të marrë nga Banka për Biznes. Efektet në ekuacionin e janë si në vijim:

Pasuria	=	Kapitali i vet	+	Detyrimet
Ndërtesat + Keshi + Inventari		Kap. I vet + Dëftesat e pagueshme + Llog. e pagueshme		
80.000€ 20.000€ 10.000€		20.000€	80.000€	10.000€
			- 8.500€	-9.000€
			+9.000€	
- 7.000€				
101.500 €		101.500 €		

Pas këtyre transaksioneve të ndodhura firma “Shala” më 31 dhjetor 2007 ndërton bilancin si në vijim:

Firma “Shala” më 31 dhjetor 2007			
Bilanci			
Pasuria	Kapitali i vet dhe detyrimet		
Ndërtesat	80.000€	Kapitali i vet	20.000€
Keshi	9.500€	Dëftesat e pagueshme	80.500€
Inventari i mallit	12.000€	Llogaritë e pagueshme	1.000€
Totali i pasurisë	101.500€	Totali i kap.të vet dhe det.	101.500€

Duke i analizuar efektet e transaksioneve të biznesit “Shala” në ekuacionin e bilancit mund të konkludojmë se varësisht prej ndikimeve të tyre, në pjesët përbërëse të ekuacionit kontabël, të gjitha transaksionet mund të grupohen në katër lloje:

- 1) **Grupi i parë i transaksioneve** ndikon në rritjen e një kategorie të pasurisë dhe për të njëjtën shumë rritet një kategori e kapitalit ose e detyrimeve. Në këtë rast për të njëjtën shumë, rritet totali i pasurisë dhe rritet totali i kapitalit të vet dhe detyrimet.

- 2) **Grupi i dytë i transaksioneve** ndikon në uljen e një kategorie të pasurisë dhe për të njëjtën shumë ulet një kategori e kapitalit të vet ose e detyrimeve. Për të njëjtën shumë ulet totali i pasurisë dhe totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve.
- 3) **Grupi i tretë i transaksioneve** ndikon në rritjen e një kategorie të pasurisë dhe për të njëjtën shumë ulet një kategori tjetër e pasurisë. Në këtë rast totali i pasurisë dhe totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve mbetën të pandryshuara.
- 4) **Grupi i katërt i transaksioneve** ndikon në uljen e një kategorie të kapitalit ose detyrimeve dhe për të njëjtën shumë rritet një kategori tjetër e kapitalit ose e detyrimeve. Në këtë rast totali i pasurisë dhe totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve mbesin të pandryshuara.

PASQYRA E TË ARDHURAVE

Pasqyra e të ardhurave raporton, në formë të përmbledhur, gjendjet (saldot) e llogarive të të hyrave, shpenzimeve dhe të fitimit neto ose humbjes neto për një periudhë të caktuar kohore, që zakonisht është një muaj ose një vit. Me fjal të tjera, kjo pasqyrë raporton suksesin operativ (afarist) të ndërmarrjes më datën e ndërtimit të saj për një periudhë caktuar kohore. Pasqyra e të ardhurave ndryshe emërtohet bilanci i suksesit, pasqyrë e fitimit dhe humbjes si dhe pasqyrë e shpenzimeve dhe të hyrave.

Qëllimi primar i kësaj pasqyre është raportimi i netofitimit ose netohumbjes të ndërmarrjes për periudhen e caktuar kontabël.

Shuma e tejkallimit të të hyrave, ndaj shpenzimeve paraqet fitimin e periudhës kontabël dhe anasjelltas, shuma e tejkallimit të shpenzimeve ndaj të hyrave paraqet humbjen e periudhës.

Në pasqyrën e të ardhurave të hyrat dhe shpenzimet prezantohen të matura mbi bazën akruale (të realizimit), prandaj sukcesi i firmës nëpërmjet kësaj pasqyre raportohet i vlerësuar mbi bazën akruale.

Të hyrat tregojnë rritjet e pasurisë ose zvogëlimin e detyrimeve që kanë rezultuar nga shitjet e mallrave ose shpenzimeve. P.sh. ndërmarrjet shesin mallra në kesh ose në afatpagese dhe me këtë rast

krijohen dy llogari të pasurisë: keshi dhe blerësit. Në këtë mënyrë duke i shitur mallrat ndërmarrja gjeneron të hyra dhe njëkohësisht rrit pasurinë. Ekzistojnë dy lloje të të hyrave:

- 1) *Operative (afariste)*
- 2) *Jooperative (financiare)*

Të hyrat operative rezultojnë prej aktivitetit primar të ndërmarrjes që në fakt është aktiviteti operativ, kurse të hyrat jooperative vijnë prej aktiviteteve dytësore dhe kryesisht kanë të bëjnë me aktivitetet financiare.

Shpenzimet përfaqësojnë zvogëlimet e pasurisë ose rritjet e detyrimeve, të krijuara nga përdorimi i pasurisë për gjenerimin e të hyrave.

Shpenzimet klasifikohen në:

- 1) *Shpenzime operative*
- 2) *Shpenzime jooperative (financiare)*

Shpenzimet operative janë të gjitha ato që ndodhin në aktivitetin operativ të firmës. Shpenzimet operative ndahen në dy lloje: a) shpenzime direkte operative dhe b) shpenzime indirekte operative.

Në shpenzimet direkte operative përfshihen ato shpenzime, shuma e të cilave në pjesëmarrjen e kostos së mallit të shitur ose në koston e prodhimeve të gatshme mund të matet me saktësi.

Tek ndërmarrjet tregtare përfaqësues kryesorë i shpenzimeve direkte është kosto e mallit të shitur. Kostoja e mallit të shitur si shpenzim në fakt e mat koston e mallit të shitur ndaj blerësve. Të ndërmarrjet prodhuese në shpenzimet direkte përfshihen: kosto e lëndës së parë, materiali dhe puna e puntorëve që punojnë drejtpërdrejt në procesin e prodhimit. Shpenzimet indirekte operative përfshijnë shpenzimet e përgjithshme të administratës, të shitjes dhe shpenzimeve tjera operative.

Formatet e pasqyrës së të ardhurave

Pasqyra e të ardhurave prezantohet si pas dy formateve:

- 1) *Formatit në shumë hapa*
- 2) *Formatit në një hap*

Sipas formatit në shumë hapa pasqyra e të ardhurave raporton kategorinë e fitimit në disa nënkategori të renditura në seksione sikur në ilustrimin vijues:

Hapi i parë	Të hyrat nga shitja e mallrave ose shërbimeve -Kostoja e mallrave të shitur = FITIMI BRUTO
Hapi i dytë	-Shpenzimet indirekte operative = FITIMI OPERATIV (EBIT)
Hapi i tretë	+Të hyrat të tjera jooperative (financiare) -Shpenzimet të tjera jooperative (financiare) = FITIMI PARA TATIMIT (EBT)
Hapi i katërt	-Shpenzimet e tatimit në të ardhura
Hapi i pestë	FITIMI NETO Fitimi për aksion (EPS) dividendi/ numri i aksioneve në zotërim

Fitimi bruto i raportuar në pasqyrën e të ardhurave është diferencë ndërmjet të hyrave nga shitjet e mallrave dhe kostos së mallit të shitur. Shuma e fitimit bruto, përkatësisht norma e tij, është një tregues i rëndësishëm për firmën sepse nëpërmjet tij, ajo projekton rrjedhat e keshit në të ardhmen.

Fitimi operativ është diferencë ndërmjet fitimit bruto dhe shpenzimeve indirekte operative (shpenzimet e administratës, të shitjes, të zhvlerësimit, të sigurimit, të taksave të ndryshme etj). Në qoftë se shpenzimet indirekte operative tejkalojnë fitimin bruto rezulton humbja operative.

Fitimi para tatimit (EBT) rezulton kur fitimit operativ i shtohen të hyrat jooperative kurse i zbriten shpenzimet jooperative. Të hyrat dhe shpenzimet jooperative kanë të bëjnë me ato kategori të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin primar të firmës. Ndryshe të hyrat dhe shpenzimet jooperative emërtohen si të hyra dhe shpenzime financiare sepse shumica e kategorive të renditura në këtë seksion kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet financiare që rezultojnë nga aktivitetet financiare siç është p.sh. kamata e paguar për huazimet e ndryshme.

Fitimi neto është komponenta finale e cila raportohet në pasqyrën e të ardhurave në shumë hapa. Fitimi neto në fakt është shuma e fitimit e realizuar nga ndërmarrja gjatë një periudhe fiskale. Ai është diferencim i fitimit para tatimit dhe shpenzimeve të tatimit në fitim. Fitimi neto paraqet rritje të kapitalit të vet ose kapitalit aksionar dhe se ai mund t’u shpërndahet pronarëve si dividendë ose të riinvestohet në ndërmarrje. Shuma e shpenzimeve të tatimit në fitim përcaktohet mbi bazën e normës së tatimit në fitim , e cila aktualisht në Kosovë është 20%. Përndryshe norma e tatimit në fitim përcaktohet me ligjet fiskale të shtetit. Firmat inokose (individuale) dhe shoqëritë partnere nuk e paguajnë drejtpërdrejt tatimin në fitim pothuajse në të gjitha shtetet e botës. Te këto biznese fitimi neto trajtohet si e ardhur personale e pronarëve.

Fitimi për aksion (EPS) llogaritet si raport ndërmjet dividendit të paguar dhe numrit të aksioneve në zotërim. Ai mat shkallën e kthimit, gjegjësisht fitimin e sendërtuar për secilin aksion të rregullt.

Formati në shumë hapa, pasqyrës së të ardhurave është si në vijim:

Firma “Ylli Bec”	
Pasqyra e të ardhurave më 31 dhjetor 2007	
Të hyrat nga shitja e mallrave	150.000
Kostoja e mallrave të shitur (KMSH)	<u>(60.000)</u>
Fitimi bruto	90.000
Shpenzimet e qirasë	(2.000)
Shpenzimet e rrymës	(1.000)
Shpenzimet e zhvlerësimit	<u>(17.000)</u>
Fitimi operativ (EBIT)	70.000

Të hyrat nga kamata	5.000
Shpenzimet e kamatës	<u>(3.000)</u>
Fitimi para tatimit (EBT)	72.000
Shpenzimet e tatimit në fitim 20%	<u>(14.400)</u>
Fitimi neto	57.600

Formati në një hap, i pasqyrës së të ardhurave, i grupon të gjitha të hyrat në seksionin e parë duke përfshirë të hyrat nga shitjet dhe të hyrat e tjera jooperative.

Në seksionin e dytë raportohen të gjithë shpenzimet, përfshirë koston e mallrave të shitur, shpenzimet operative dhe shpenzimet jooperative. Totali i shpenzimeve zbritet nga totali i të hyrave dhe në fund të kësaj pasqyre raportohet fitimi neto ose humbja neto e periudhës.

Pasqyra e të ardhurave në një hap, ilustruar me shembullin e firmës “Ylli Bec” është si vijon:

Firma “Ylli Bec”	
Pasqyra e të ardhurave më 31 dhjetor 2007	
Të hyrat nga shitja e mallrave	150.000
Të hyrat nga kamata	<u>5.000</u>
Totali i të hyrav	155.000
Kostoja e mallrave të shitur	(60.000)
Shpenzimet e qirasë	(2.000)
Shpenzimet e rrymës	(1.000)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(17.000)
Shpenzimet e kamatës	(3.000)
Shpenzimet e tatimi në të ardhura 20%	<u>(14.400)</u>
Totali i shpenzimeve	<u>(97.400)</u>

Fitimi neto

57.600

Në pasqyrën e të ardhurave kategoritë dhe rezultati i aktivitetit operativ prezantohet mbi bazën e dy metodave :

- 1. Metoda sipas natyrës së shpenzimeve**
- 2. Metoda sipas funksionit të shpenzimeve (metoda e kostos së mallit të shitur)**

Në suazat të **metodës sipas natyrës së shpenzimeve**, kategoritë e të hyrave dhe shpenzimeve, grupohen sipas natyrës së tyre. Kategoritë e të hyrave operative dhe të hyrave të tjera operative, raportohen në krye të pasqyrës së të ardhurave të grupuara sipas natyrës së tyre. Kategoritë e shpenzimeve brenda metodës në fjalë kërkohet të raportohen në kategori të veqanta sipas natyrës së tyre si p.sh. shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit, shpenzimet e pagave, të lëndës së parë, dhe shpenzimet e tjera operative.

Brenda **metodës së shpenzimeve, sipas funksionit**, shpenzimet grupohen sipas funksionit dhe qëllimit të tyre në kategori të veqanta si p.sh. në koston e mallrave të shitur, në shpenzimet administrative, në shpenzimet e shitjes dhe në shpenzimet tjera operative. Në qoftë se pasqyra e të ardhurave prezantohet mbi bazën e metodës së shpenzimeve sipas funksionit, atëherë kostoja e mallrave të shitur raportohet nën të hyrat nga shitjet për t'u raportuar fitimi bruto.

Shpenzimet tjera operative renditen nën fitimin bruto për t'u raportuar fitimi operativ. Kurse shpenzimet jooperative renditen nën fitimin operativ për të raportuar në pasqyrën e të ardhurave fitimin para tatimit. Shpenzimet e tatimit në fitim dhe fitimi neto i periudhës brenda metodës në fjalë raportohen si kategori të veçanta.

Pasqyra e të ardhurave e prezantuar në shembullin e “Ylli Bec” është prezantuar mbi bazën e metodës së shpenzimeve sipas funksionit ose koston së mallrave të shitur. Kjo metodë përdoret më shumë te firmat tregtare. Ndërsa metoda e shpenzimeve, sipas natyrës, përdoret më shumë te firmat prodhuese.

Sipas SNK- it, numër një, pasqyra e të ardhurave në metodën e shpenzimeve sipas natyrës duhet të jetë strukturuar sikur në skemën vijuese:

Pasqyra e të ardhurave sipas natyrës së shpenzimeve

Firma "N"	
Pasqyra e të ardhurave më 31 dhjetor 2009	
Të hyrat	x
Të hyrat të tjera operative	x
Ndryshimet në inventarin e produkteve	
të gatëshme dhe prodhimit në proces	(x)
Puna e kryer dhe e kapitalizuar nga ndërmarrja	x
Lëndët e para të përdorura	
dhe të konsumueshme (harxhime) të tjera	(x)
Shpenzimet e pagave të punonjësve	(x)
Shpenzimet e amortizimit	(x)
Shpenzimet e zhvlerësimit (të tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajimeve	(x)
Shpenzime të tjera	(x)
Kostot e financimit	(x)
Pjesë e fitimit nga pjesëmarrjet	<u>(x)</u>
Fitimi para tatimit	x
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	<u>(x)</u>
Fitimi neto i periudhës	x
Fitimi i periudhës që u takon zotëruesve	
të kapitalit të kompanisë mëmë	x
Fitimi i periudhës që i takon interesit pakicë (aksionarëve të filialit)	x

PASQYRA E RRJEDHAVE TË PARASË (keshit)

Qëllimi kryesor i pasqyrës së rrjedhave të parasë është sigurimi i informacionit për biznesin lidhur me aktivitetet që ndikojnë në hyrjet dhe daljet e parasë gjatë një periudhe fiskale. Me fjalë të

tjera, pasqyra e rrjedhave të parasë raporton transaksionet prej të cilave është gjeneruar paraja si dhe transaksionet për të cilat është përdorur paraja.

Brenda kësaj pasqyre këto aktivitete raportohen të klasifikuara mbi bazën e aktiviteteve kryesore të biznesit në tri lloje:

- a) **Aktivitetet operative**
- b) **Aktivitetet investuese**
- c) **Aktivitetet financuese**

Ndryshme nga bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave, të cilat ndërtohen mbi bazën e kontabilitetit akrual, pasqyra e rrjedhave të keshit aktivitetet operative, investuese dhe financuese i raporton të matura mbi bazën e keshit.

Rrjedha të parasë janë hyrjet ose daljet e mjeteve në para dhe ekuivalentëve të parasë. Mjetet në para përfshijnë paratë në dorë (arka) dhe depozitat monetore në bankë me dhe pa afat. Ndërsa ekuivalentët e parasë janë investimet në letra me vlerë afatshkurtra me likuiditet të lartë që do të thote se ato mund të konvertohen në para, në çdo kohë, pa ndonjë rrezik të madh.

Meqenëse termi kesh, i raportuar si kategori në bilanc, konform SNK-ve i nënkupton edhe ekuivalentet e tjerë të parasë dhe nisur nga fakti se ky term është bërë më i përdorshmi në gjuhën univesale të biznesit dhe teorinë bashkëkohore të kontabilitetit, në vazhdim të këtij teksti në të shumtën e herave, është përdorur emërtimi kesh sepse edhe në Kosovë biznesi është familjarizuar me përdorimin e këtij termi, në aktivitetet financiare të tyre.

Pasqyra e rrjedhave të keshit në të kaluarën është njohur me emërtimin pasqyrë e rrjedhave të fondëve. Përgatitja e pasqyrave e rrjedhave të keshit bëhet në bazë të dy metodave, përkatësisht dy formateve dhe atë :

- a) **Metodës direkte**
- b) **Metodës indirekte**

Metodat në fjalë ndryshojnë ndërmjet tyre vetëm në seksionin e aktiviteteve operative (afariste). Raportimi i rrjedhave të keshit nga aktivitetet investuese dhe financuese është identik në të dy metodat.

Në **metodën direkte** netorrjedhat e keshit prej aktiviteteve operative maten si diferencë e hyrjeve dhe daljeve të keshit nga transaksionet operative primare siç janë p.sh. blerjet dhe shitjet e mallrave etj. Ndërsa në **metodën indirekte** netorrjedhat e keshit prej aktiviteteve operative vlerësohen duke e rregulluar fitimin neto të periudhës me efektet e transaksioneve dhe kategorive që nuk janë të natyrës monetare.

Transaksionet, me natyrë jomonetare, janë hyrjet dhe daljet e keshit për shtyrjet të cilat kanë ndodhur në të kaluarën si dhe hyrjet dhe daljet e keshit për akrualet, të cilat ndodhin në periudhat e ardhshme. Kategori, të cilat korrigjohen nga fitimi neto i bazës akruale, janë të hyrat dhe shpenzimet të cilat ndërlidhen me aktivitetin investuese dhe financuese.

Matja akruale e fitimit neto praktikisht nënkupton se të hyrat e përfshira në matjen e fitimit neto janë vlerësuar mbi bazën e parimit të realizimit. Kjo do të thotë se vlerësimi, përkatësisht njohja e të hyrave nga shitjet, nuk është bazuar në arkëtimet e keshit në emër të tyre. Në anën tjetër shpenzimet e përdorura për llogaritjen e fitimit neto të periudhës në këtë rast janë matur në bazë të parimit akruale (shkakësisë). Matja e shpenzimeve, sipas parimit të shkakësisë, nënkupton se për vlerësimin e fitimit neto në bazë akruale kërkohet që të hyrave të njohura, gjatë një periudhe, duhet kundërvënë shpenzimet e të njëjtës periudhë, të cilat kanë mundësuar krijimin e atyre të hyrave. Prandaj fitimi neto, i vlerësuar në bazë të kontabilitetit akruale në seksionin e aktiviteteve operative brenda metodës indirekte duhet të harmonizohet me bazën e keshit. Shuma e fitimit neto, e harmonizuar me bazën e keshit brenda metodës indirekte në seksionin e aktiviteteve operative, në fakt paraqet shumën e netorrjedhave të keshit prejaktiviteteve operative. Dallimet e përgjithshme, ndërmjet metodës direkte dhe indirekte, po i ilustruam në skemën vijuese:

Metoda direkte

Rrjedhat e keshit prej aktiviteteve operuese

1.

Arkëtimet në kesh prej aktiviteteve operuese

-Pagesat në kesh për aktivitetet operuese

=Netorrjedhat e keshit prej aktiviteteve operuese

Rrjedhat e keshit prej aktiviteve investuese

Arkëtimet në kesh prej aktiviteve investuese

-Pagesat në kesh për aktivitetet investuese

=Netorrjedhat e keshit prej aktiviteve investuese

2.

Rrjedhat e keshit prej aktiviteve financuese

Arkëtimet në kesh prej aktiviteve financuese

-Pagesat në kesh për aktivitetet financuese

=Netorrjedhat e keshit prej aktiviteve financuese

3.

Metoda indirekte

Rrjedhat e keshit aktiviteve operative

1.

Fitimi neto
+ Rregullimet (korrigjimet) e fitimit neto
= Netorrjedhat e keshit prej aktiviteve operuese

Rrjedhat e keshit prej aktiviteve investuese

2.

Arkëtimet në kesh prej aktiviteve investuese
-Pagesat në kesh për aktivitetet investuese
= Netorrjedhat e keshit prej aktiviteve investuese

Rrjedhat e keshit prej aktiviteve financuese

3.

Arkëtimet në kesh prej aktiviteve financuese
-Pagesat në kesh për aktivitetet financuese
= Netorrjedhat e keshit prej aktiviteve financuese

Pasqyra e rrjedhave të keshit përgatitet në fund të periudhës nga të dhënat e raportuara në bilancin e gjendjes dhe në pasqyrën e të ardhurave. Prej këtyre pasqyrave merren të dhënat e integruara, të saldaove fillestare dhe përfundimtare të kategorive të bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave, të cilat pastaj në bazë të rregullave të kontabilitetit transformohen në të dhëna adekuate për identifikimin e rrjedhave të keshit prej aktiviteve të biznesit. Në këtë tekst jemi fokusuar kryesisht në trajtimin e metodës direkte.

Metoda direkte

Në metodën direkte pasqyra e rrjedhave të keshit raporton të gjitha shumat e rëndësishme, lidhur me burimet dhe përdorimet e keshit në aktivitetet kryesore të biznesit të parcializuara në tri seksione:

- 1) *Rrjedhat e keshit prej aktiviteve operuese*
- 2) *Rrjedhat e keshit prej aktiviteve investuese*
- 3) *Rrjedhat e keshit prej aktiviteve financuese*

Aktivitetet operuese janë të gjitha transaksionet që lidhen me aktivitetin primar të biznesit. Transaksionet e tilla janë prodhimi, blerjet e mallrave dhe shërbimeve si dhe shitjet dhe distribuimi i tyre tek blerësit etj. Në rrjedhat e keshit prej aktiviteve operuese konform SNK-së përfshihen transaksionet lidhur me:

Hyrjet në kesh

- ✓ *Nga arkëtimet e shitjes së mallrave dhe shërbimeve*
- ✓ *Nga arkëtimet në emër të kamatës, të dividendit, provizioneve (komisioneve), tarifave, premive të sigurimit dhe të ardhurave të tjera*
- ✓ *Nga arkëtimet e shitjeve të instrumenteve financiare afatshkurtëra.*

Daljet në kesh

- ✓ *Për blerjen e mallrave dhe shërbimeve*
- ✓ *Për pagesat e pagave të stafit punues*
- ✓ *Për pagesat e shpenzimeve të shërbimeve publike (rrymes, ujit, mbeturinave)*
- ✓ *Për pagesat e polisave të sigurimit dhe kamatës*
- ✓ *Për pagesat e tatimeve të ndryshme*
- ✓ *Për pagesat e kontratave të ndërmjetësimit*
- ✓ *Për blerjen e investimeve financiare afatshkurtra etj.*

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe të amortizimit nuk janë kategori e rrjedhave monetare, prandaj të njëjtat nuk përfshihen në aktivitetet operative dhe investuese.

Inormacionet për rrjedhat e keshit nga aktivitetet operative është i dobishëm për menaxhmentin dhe grupet tjera jashtë firmës, në radhë të parë për të vlerësuar qëndrueshmërinë financiare të biznesit.

Mbi bazën e rrjedhave të keshit nga aktivitetet operative mund të vlerësohen: mbajtja e kapacitetit afaristë të firmës, shkalla e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, mundësitë për investimet e reja kapitale pa pasur nevojë përdorimin e kapitalit borgj etj. Njëkohësisht informacioni i rrjedhave të keshit prej aktiviteteve operative së bashku me informacionet e rrjedhave të keshit prej aktiviteteve investuese dhe financuese mund t'i shërbejë firmës si bazë e rëndësishme për parashikimin e rrjedhave të keshit të biznesit ne periudhat e ardhshme.

Aktivitetet investuese të biznesit janë të gjitha transaksionet që kanë të bëjnë me blerjen dhe shitjen e pasurisë afatgjatë. Shëmbuj të transaksioneve që përfshihen në aktivitetet investuese janë: blerjet dhe shitjet e patundëshmërive impianteve, pajimeve së pasurisë së paprekshme, investimeve financiare dhe dhëniet si dhe rikthimi i huave nga firma. Në rrjedhat e keshit prej aktiviteteve investuese përpos SNK-ve duhet përfshihen këto transaksione:

Hyrjet në kesh

- ✓ *Arkëtimet e shitjeve të patundëshmërive, impianteve, pajimeve, pasurisë së paprekshme, investimeve financiare afatgjata.*
- ✓ *Arkëtimet nga rikthimi i huave të dhëna më parë nga firma.*
- ✓ *Arkëtimet nga shitjet e investimeve derivative të letrave me vlerë të tilla si kontratat e të ardhurës (faturës) kontratat forëard, kontratat opSION, kontratat e këmbimit.*

Daljet në kesh

- ✓ *Për pagesat e blerjeve të patundëshmërive, impianteve, pajimeve, pasurisë së paprekshme, investimeve financiare afatgjata.*
- ✓ *Për dhënien e huave nga firma*
- ✓ *Për vlerën e derivateve të kompanive të tjera të tilla si kontratat e të ardhurës (faturës) kontratat forëard, kontratat opSION, kontratat e këmbimit.*

Informacioni për rrjedhat e keshit nga aktivitetet investuese është i dobishëm për t'u njohur më nivelin e përdorimit të resurseve ekonomike, të cilat ajo do t'i përdorë për gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e rrjedhave të reja të keshit në të ardhmen.

Ativitetet financuese i përfshijnë transaksionet e rrjedhave të keshit që lidhen me financimin e brendshëm dhe të jashtëm të biznesit. Kur kompanitë e fillojnë aktivitetin e tyre biznesor atyre u nevojitet kapital fillestar, i cili më se lehti sigurohet nga emetimi i aksioneve. Gjithashtu gjatë aktivitetit të tyre biznesor ato mund të financohen nëpërmjet obligacioneve, huazimeve bankare (dëftesat e premtueshme) dhe instrumenteve të tjera të borxhit.

Financimi i firmës nga emetimi i aksioneve, obligacioneve dhe pagesat në kesh për blerjen e aksioneve nga pronarët e saj, pagesat e dividendit, etj., janë shembul tipikë të aktiviteteve financuese. Rrjedhat e keshit prej aktiviteteve financuese, raportohen në seksionin e tretë të pasqyrës së rrjedhave të keshit: sipas SNK-së në pasqyrën e rrjedhave të keshit duhet raportuar transaksione si në vijim:

Hyrjet në kesh

- ✓ *Nga emetimi i aksioneve të rregullta dhe preferenciale, emetimi i obligacioneve si dhe emetimi i instrumenteve të tjera të borxhit afatgjatë dhe afatshkurtër.*

Daljet në kesh

- ✓ *Për pagesën e dividendit*
- ✓ *Për riblerjen e aksioneve nga aksionarët e vet (aksionet e thesarit)*
- ✓ *Për ripagesën e kryegjës (principalit) të obligacioneve, të huave bankare etj, përfshirë edhe qiranë kapitale.*

Informacioni për rrjedhat e keshit nga aktivitetet financuese është i dobishëm për përdoruesit sepse në bazë të tij mund të parashikohen kërkesat për financimin e firmës në të ardhmën. Pasqyra e rrjedhave të keshit përgatitet mbi bazën e të dhënave të raportuara në bilanc dhe në pasqyrën e të

ardhurave. Në këtë pjesë të tekstit në vazhdim do të ilustronim një shembull nga i cili do të shpjegohet sistemi i transaksioneve brenda aktiviteteve përkatëse në pasqyrën e rrjedhave të keshit.

Shembull:

Le të supozojmë se gjatë vitit 2007 tek firma “Elkos” kanë ndodhur këto transaksione (ngjarje) lidhur me arkëtimie (mbledhje në kesh) dhe pagesat në kesh:

Më 01.01.2007 saldo (gjendja) e llogarisë keshi është 60.000 €.

03.01.2007 janë arkëtuar (mbledhur në kesh) 165.00 € nga blerësit për mallrat e shitur më parë.

08.01.2007 janë paguar 80.000 € ndaj furnitorëve për mallin e blerë.

31.01.2007 janë paguar 20.000 € për shpenzimet e pagave të stafit punues.

05.02.2007 janë emetuar 500 aksione të rregullta në kesh me vlerë të tregut nga 10 € për aksion.

Firma “Elkos”	
Pasqyra e rrjedhave të keshit më 31.12.2007	
Aktivitetet operuese	
Hyrjet në kesh:	
Prej blerësve (nga shitjet e mallrave)	165.000 €
Prej të hyrave nga dividendeët	10.000 €
Prej provizioneve (komisioneve)	5.000 €
Daljet në kesh:	
Ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave	(80.000 €)
Për pagesa të stafit punues	(20.000 €)
Për shërbimet publike (rrymë, ujë, mbeturina)	(10.000 €)
Për tatimin në të ardhurat e korporatës	(30.000 €)
Për polisat e sigurimeve	<u>(20.000 €)</u>
Netorritjet / pakësimet e keshit prej aktiviteteve operuese	20.000 €

Aktivitetet investuese	
Hyrjet në kesh:	
Prej shitjes së patundëshmërive	50.000 €
Daljet në kesh:	
Për investimet në aksionet e “Migros”	(60.000 €)
Për blerjen e makinerive	<u>(30.000 €)</u>
Netorritjet / pakësimet e keshit prej aktiviteteve investuese	(40.000 €)
Aktivitetet financiare	
Hyrjet në kesh:	
Prej emetimit të aksioneve	50.000 €
Prej huazimit bankar (kreditit)	150.000 €
Daljet në kesh:	
Për pagesën e kryegjësë	(20.000 €)
Për riblerjën e aksioneve të thesarit	(15.000 €)
Për pagesën e dividendëve	<u>(20.000 €)</u>
Netorritjet /pakësimet e keshit prej aktiviteteve financiare	145.000 €
Netorrjedhat e keshit gjatë periudhës	125.000 €
Gjendja e keshit në fillim të periudhës	<u>60.000 €</u>
Gjendja përfundimtare e keshit 31.12.2007	185.000 €

20.02.2007 është paguar kryegjësja (principali) e kreditit ndaj bankës NLB në vlerë prej 20.000 €.

10.03.2007 janë blerë në kesh 1.000 aksione të rregullta prej aksionarëve të vet (aksionet e thesarit) nga 15 € për aksion.

20.04.2007 janë pranuar në kesh 150.000 € në emër të kreditit afatgjatë nga banka Raiffeisen.

25.04.2007 “Elkos” ka investuar në blerjen e 3.000 aksioneve të rregullta të kompanisë “Migros” nga Zvicra. Ato janë blerë në kesh 20 € për aksion.

02.06.2007 janë paguar 30.000 € për blerjen e makinerive.

10.06.2007 është paguar dividendi në kesh për aksionarët e vet në vlerë prej 20.000 €.

20.06.2007 janë paguar 10.000 € për shpenzime të shërbimeve publike (rrymë, ujë, mbeturina).

10.09.2007 janë arkëtuar 50.000 € në emër të shitjes së një lokali afarist.

20.09.2007 është paguar 30.000 € për tatimin në të ardhurat e korporatës.

15.10.2007 janë paguar 20.000 € për polisat e sigurimeve të automjeteve.

02.11.2007 janë pranuar në kesh 10.000 € në emër të dividendit për aksionet e blera nga “Migros”.

01.12.2007 janë arkëtuar 5.000 € nga provizionet (komisionet) e shitjes.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar

Pasqyra e kapitalit aksionar raporton informacionin për ndryshimet në gjendjen e kapitalit aksionar të kompanisë gjatë një periudhe fiskale. Në përgatitjen e pakos (grupit) së pasqyrave financiare, pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar shërben si urë lidhëse ndërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe bilancit, sepse fitimi neto i periudhës është pjesë përbërëse e kësaj pasqyre dhe në të njëjtën përshkruhet detajisht shuma e tij e cila është mbajtur për t'u reinvestuar në korporatë. Gjendja përfundimtare e fitimit të mbajtur në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit aksionar përfaqëson shumën, e cila raportohet në bilancin e gjendjes brend kategorisë së kapitalit aksionar. Kjo pasqyrë financiare ndryshe emërtohet edhe pasqyrë e kapitalit aksionar dhe ndonjëherë në literatur paraqitet edhe në versionin e pasqyrë e fitimit të mbajtur.

Në ndryshimet e shumës së kapitalit aksionar ndikojnë kryesisht emetimet e reja të aksioneve, blerja e aksioneve prej aksionarëve të vet (aksionet e thesarit), fitimi ose humbja neto e periudhës si dhe deklaratimet ose pagesat e dividendit.

Dy komponentet kryesore, përkatësisht burimet e kapitalit aksionar janë:

- 1. Kapitali i kontribuar dhe**
- 2. Fitimi i mbajtur**

Kapitali i kontribuar paraqet shumën e investuar në korporatë nga ana e pronarëve të saj. Me fjalë të tjera, kapitali i kontribuar përfaqëson shumën e paguara nga aksionarët në kohën e shitjes së aksioneve nga korporata.

Kapitali i kontribuar, në këtë pasqyrë, përfshinë të gjitha aksionet në zotërim sipas vlerës nominale si dhe preminë në aksione. Gjendja e kapitalit të kontribuar gjatë një periudhe fiskale ndryshon nga emetimet shtesë (të reja) të aksioneve si dhe nga blerja e aksioneve prej aksionarëve të saj. Kapitali i kontribuar rritet nga çdo emetim i ri i aksioneve, ndërsa zvogëlohet nga çdo riblerje e aksioneve prej aksionarëve të vet.

Fitimi i mbajtur është shuma e fitimit neto të pashpërndarë për dividend, i cili mbahet për t'u reinvestuar në korporatë. Gjendja e fitimit të mbajtur gjatë një periudhe fiskale ndryshon nga fitimi humbja neto e periudhës si dhe nga deklarimit e dividendit.

Fitimi i mbajtur rritet nga fitimi neto i periudhës, kurse zvogëlohet nga humbja neto e periudhës dhe nga deklarimet e dividendit

Dividendët nuk janë shpenzime, prandaj nuk raportohen në pasqyrën e të ardhurave por të njëjtit raportohen në pasqyrën e kapitalit aksionar si kategori që e zvogëlon fitimin e mbajtur. Në fakt dividendët janë llogari e kundërt e llogarisë së fitimit të mbajtur, prandaj gjithmonë në fund të periudhës ajo llogari mbyllet me llogarinë e fitimit të mbajtur.

Shembull:

Le të supozojmë se korporata "S" më 1 janar 2007 ka pasur këtë gjendje fillestare në llogaritë e kapitalit aksionar: kapitali i kontribuar 230.000 € (vlera nominale e aksioneve dhe premia në aksione) dhe fitimi i mbajtur 120.000€.

Gjatë vitit 2007 te korporata "S" kanë ndodhur këto transaksione të ndërlidhura me kapitalin aksionar:

- 1) Më 20 shkurt janë emetuar në kesh 5.000 aksione të rregullta sipas vlerës së tregut nga 20€ për aksion.
- 2) Më 10 maj janë blerë 1.000 aksione të rregullta prej aksionarëve të vet nga 25€ për aksion. Këto aksione korporata "S" nuk i anulon por të njëjtat pretendon t'i mbajë për t'u dhënë bonuse puntorëve të saj.
- 3) Më 1 korrik është deklaruar dhe paguar dividendë në kesh për të gjitha aksionet në zotërim në vlerë prej 70.000 €.
- 4) Më 31 dhjetor korporata "S" ka llogaritur dhe raportuar fitimin neto të periudhës në vlerë prej 100.000 €.

Korporata "S" ndërton pasqyrën e ndryshimit të kapitalit aksionar për vitin 2007 si në vijim:

Firma "S"

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar më 31.12.2007

Data	Kapitali i kontribuar	Fitimi i mbajtur	Kapitali Aksionar
1.01.2007	230.000€	120.000	350.000€
20.02 (shitja e aksioneve)	100.000€		100.000€
10.05 (blerja e aks. të rreg.)	(25.000€)		(25.000€)
10.07 (deklarimi i dividendit)		(70.000€)	(70.000€)
31.12 (fitimi neto i periudhës)	_____	<u>100.000€</u>	<u>100.000€</u>
Saldo më 31.12.2007	305.000€	150.000€	455.000€

Procesi i regjistrimit kontabël

Njësitë e procesit kontabël

Në procesin e tij, kontabiliteti është i fokusuar në sigurimin dhe regjistrimin e transaksioneve të cilat kanë ndikime ekonomike në firmë, sepse jo të gjitha transaksionet ndikojnë në ndryshimet e pozitës financiare të firmës. Instrumenti kryesor i procesit kontabël pa dyshim është llogaria.

Llogaria (konto) është një format standard, e cila përdoret për grumbullimin e efekteve monetare të transaksioneve për çdo element të pasqyrave financiare. Nga kontabilistët, ajo konsiderohet si njësi bazike e procesit kontabël.

Në mënyrë të detajzuar, në llogari regjistrohen të gjitha ndryshimet në vlera monetare të të gjitha kategorive të veçanta të pasurisë, të kapitalit dhe detyrimeve. Me përdorimin e llogarisë fillon dhe mbaron procesi kontabël.

Ditari, si njësi tjetër bazike e procesit kontabël, përdoret për regjistrimin e transaksioneve në mënyrë kronologjike sipas datave të ndodhjes së tyre. Gjithmonë transaksionet fillimisht regjistrohen në ditar dhe pastaj barten në librin kryesor

Libri kryesor (i madh) është një regjister në të cilin përfshihen të gjitha llogaritë. Të dhënat e llogarive në librin kryesor, në fakt janë të dhëna të kopjuara (bartura) drjetpëdrjet prej ditarit.

Sistemi i regjistrimit të dyfishtë

Në kontabilitet regjistrimi i transaksioneve bazohet në sistemin e dyfishtë. Regjistrimi i dyfishtë nënkupton se efektet e çdo transaksioni evidencohen së paku në dy llogari sepse çdo ndërrim ekonomik ka efekte të dyanshme. P.sh në qoftë se një firmë blen mallra në vlerë prej 1.000 € me afat pagese

(llogari të hapur) një muaj, ky transaksion ndikon në rritjen e llogarisë së mallrave prej 1.000 € dhe për të njëjtën shumë rritet llogaria e furnitorëve.

Fillet e kontabilitetit të dyfishtë lidhen me emrin e matematikanit të famshëm italian, Luka Pacioli. Ai në vitin 1494 i përdori për herë të parë nocionet debi dhe kredi dhe të njëjtat emërtime edhe tani në mënyrë universale përdoren në tërë botën.

Lloraria (konto) T

Forma më e thjeshtë e llogarisë, e cila përdoret në analizën e transaksioneve, është ajo sikur shkronja e madhe T. Përndryshe format univesale të llogarive të librit kryesor do t'i prezantojmë në vazhdim të këtij kapitulli.

Llogaria e formës T përbëhet prej tri elementeve.

- a) Titullit të llogarisë**
- b) Anës së majtë (debitit)**
- c) Anës së djathtë (kreditit)**

Në krye të llogarisë T është emri i përcaktuar për pasurin, kapitalin aksionar ose detyrimet. Një vijë vertikale e ndan llogarinë në dy pjesë, në anën e majtë dhe në anën e djathtë. Ana e majtë e llogarisë quhet ana e debisë kurse ana e djathtë quhet ana e kredisë.

Në mënyrë vizuale p.sh. llogaria T e keshit është si në vijim:

Keshi

Debiti	Kreditit
---------------	-----------------

Debiti dhe krediti

Në kontabilitet, termat debi dhe kredi përdoren për të specifikuar anën e majtë dhe anën e djathtë të llogarisë. Studentët të cilët fillojnë studimet në kontabilitet, dhe të tjerët që nuk janë profesionistë kontabël, shpesh herë kur i takojnë termat e debisë dhe kredisë i kuptojnë gabimisht rregullat e tyre. Në këtë rast ata mendojnë se debiti nënkupton rritjen, ndërsa krediti përfaqëson zvogëlimin e llogarisë

Termet debi dhe kredi janë terma ndërkombëtarë të kontabilitetit dhe thjesht u referohen vetëm anës së majtë dhe anës së djathtë të llogarisë **T**. Përndryshe rritja dhe zvogëlimi i llogarisë në anën e debisë dhe në atë të kredisë varet drejtpërdrejt nga lloji i llogarisë.

Disa llogari rriten në anën e debisë, ndërsa të tjerat rriten në anën e kredisë dhe në të kundërtën disa llogari zvogëlohen në anën e kredisë.

Termi debi, kur përdoret si folje debiton, kontabilistët e regjistrojnë shumën në debi, ndërsa termi kredi kur përdoret si folje krediton, regjistrimi bëhet në anën e kredisë. Për termat debi dhe kredi kontabilistët i përdorin shkurtesat Dr dhe Cr.

Rregullat e debisë dhe kredisë për regjistrimin e rritjeve dhe zvogëlimeve të të gjitha kategorive të bilancit qartësohen më së miri nëpërmjet ekuacionit të bilancit si në vijim:

Pasuria		=	Kapitali		+	Detyrimet	
Debi	Kredi		Debi	Kredi		Debi	Kredi
Rritjet	Zvoglimet		Zvoglimet	Rritjet		Zvoglimet	Rritjet

Debiti = Krediti

Çdo transaksion ndikon në dy ose më shumë llogari të ekuacionit bazik të kontabilitetit për të mbajtur të njëjtin në barazpeshë. Nga kjo rezulton, se për çdo transaksion totali i debisë dhe totali i kredisë duhet të jetë i barabartë. Me fjalë të tjera barazimi i totalit të debisë dhe kredisë në regjistrimin e çdo transaksioni paraqet bazën e kontabilitetit të dyfishtë. Në qoftë se në secilin transaksion totali i debisë është i barabartë me totalin e kredisë, atëherë mbi bazën e logjikës kontabël rrjedh se totali i debisë, i të gjitha llogarive është i barabartë me totalin e kredisë së të gjitha llogarive.

Zgjerimi i ekuacionit të bilancit

Të hyrat dhe shpenzimet janë nënkategori të fitimit të mbajtur dhe në ekuacionin bazik të kontabilitetit ato përfshihen në totalin e kapitalit aksionar, meqenëse fitimi i mbajtur është komponent përbërës i kësaj kategorie. Për të hyrat dhe shpenzimet, në kontabilitet mbahen llogaritë e veçanta. Rregullat për rritjet dhe zvogëlimet e këtyre llogarive krijohen mbi bazën e logjikës kontabël si në vijim:

- a) *Fitimi i mbajtur rritet në anën e kredisë*
- b) *Të hyrat janë një rritje në fitimin e mbajtur.*

Mbi bazën e këtyre dy rregullave të lartcekura rrjedh se regjistrimi i rritjeve në llogarinë e të hyrave duhet të bëhet në anën e kredisë, ndërsa zvogëlimet në debi. Kjo në fakt paraqet rregullën e regjistrimit të rritjeve dhe zvogëlimeve në llogarinë e të hyrave. Ngjashëm me të hyrat edhe për shpenzimet krijohen rregullat për regjistrimin e rritjeve dhe zvogëlimeve në llogari të shpenzimeve si në vijim:

- a) *Fitimi i mbajtur zvogëlohet në anën e debisë*
- b) *Shpenzimet janë një zvogëlim në fitimin e mbajtur.*

Nga këto dy rregulla rezulton rregulla për regjistrimin e rritjeve dhe zvogëlimeve në llogarinë e shpenzimeve. Sipas kësaj rregulle, në llogarinë e shpenzimeve, rritjet regjistrohen në anën e debisë, kurse zvogëlohet në kredi.

Devidendët kur deklarohen e ulin fitimin e mbajtur. Prandaj rritjet e kësaj llogarie regjistrohen në anën e debisë kurse zvogëlohet në anën e kredisë.

Ekuacioni bazik I kontabilitetit në formë të zgjeruar, i cili involvon edhe të hyrat, shpenzimet dhe dividendin është në vijim.

Pasuria = Kapitali aksi. + Fitimi i mbaj+ Detyrimet+ Të hyrat- Shpenzimet- Dividendi

Dr. / Cr.	Dr. / Cr.	Dr. / Cr.	Dr. / Cr.	Dr. / Cr.	Dr. / Cr.	Dr. / Cr.
+ / -	- / +	- / +	- / +	- / +	+ / -	+ / -

Rregullat për rritjen dhe zvogëlimet e të gjitha llojeve të llogarive në formë të përmbledhur janë:

Llojet e llogarive	Në Debi	Në Kredi
Pasuria	Rritet +	Zvogëlohet -
Kapitali aksionar	Zvogëlohet -	Rritet +
Detyrimet	Zvogëlohet -	Rritet +
Të hyrat	Zvogëlohet -	Rritet +
Shpenzimet	Rritet +	Zvogëlohet -
Dividendët	Rritet +	Zvogëlohet -

Saldot (gjendjet) normale të llogarisë

Diferenca ndërmejt totalit të debisë dhe totalit të kredisë emërtohet saldo (gjendje, tepricë, balancë) e llogarisë. Çdo llogari e pasqyrave financiare në fund të periudhës kontabël ka një saldo debitore ose kreditore. Në qoftë se shuma e totalit të debisë e tejkalon totalin e kredisë, llogaria ka saldo (gjendje) debitore dhe anasjelltas në qoftë se totali i kredisë tejkalon totalin e debisë llogaria ka saldo kreditore. P.sh le të supozojmë se llogaria e keshit në fund të periudhës ka këto shuma të eciencuara në orën e debisë dhe kredisë sikur në vijim:

Debi

Keshi

Kredi


25.000	5.000
10.000	15.000
30.000	25.000
5.000	
Saldo 25.000	

Në llogarinë e keshir, diferenca ndërmjet totalit të debisë 70.000€ dhe totalit të kredisë prej 45.000€ është 25.000€. Për këtë shumë totali i debisë së llogarisë keshi është më i lartë. Prandaj në shembullin konkret shuma prej 25.000€ paraqet saldon (gjendjen) debitore të llogarisë së keshit.

Llogaritë e pasurisë saldon e tyre normale e kanë debitore


Duke i kujtuar rregullat e debisë dhe të kredisë rrjedh se të gjitha llogaritë e pasurisë rriten në anën e debisë, kurse zvogëlohen në anën e kredisë.

Meqenëse ana e debisë në shumën monetare gjithmonë është më e madhe se ana e kredisë, është e natyrshme që të gjitha llogaritë e pasurisë e kanë gjendjen normale debitore



Llogaritë e kapitalit aksionar dhe të detyrimeve, saldo (gjendjen) normale të tyre e kanë kreditore. Rritjet e këtyre llogarive regjistrohen në anën e kredisë, kurse zvogëlimet në anën e debisë.


Shumat monetare të regjistruara në anën e kredisë së këtyre llogarive tejkalojnë gjithmonë shumën monetare të evidencuar në anën e kredisë, prandaj llogaritë e tilla gjendjen normale të tyre e kanë kreditore.



Saldo normale	Saldo normale
Kreditore	Kreditore


Fitimi i mbajtur përfaqëson netofitimin e firmës, i cili nuk është shpërndarë, qoftë për dividend ose për t’u reinvestuar në firmë. Rritjet e llogarisë së fitimit të mbajtur regjistrohen në anën e kredisë, kurse zvogëlimet regjistrohen në anën e debisë. **Llogaria e fitimit të mbajtur saldon normale e ka kreditore.**

Dividendët përfaqësojnë shpërndarjen e keshit ose ndonjë pasurie tjetër nga ana e kompanisë për aksionarët e saj. Rritjet e dividendit regjistrohen në debi të kësaj llogarie, kurse zvogëlimet në anën e kredisë. **Saldo normale e llogarisë së dividendit është debitore.**



Të hyrat janë kategori e fitimit të mbajtur. Kur të hyrat njihen në kontabilitet, rritjet e tyre regjistrohen në kredi, kurse zvogëlimet në debi të llogarisë së të hyrave. **Saldo normale e llogarisë së të hyrave është kreditore.**

Shpenzimet e zvogëlojnë fitimin e mbajtur. Rritjet e këtyre llogarive regjistrohen në debi, kurse zvogëlimet në kredi. **Saldo normale e llogarisë së shpenzimeve është debitore.**



Saldo normale	Saldo normale
Kreditore	Debitore

Në mënyrë të përmbledhur saldot normale të llogarive janë si në vijim:

Lloji i llogarisë	Saldot (gjendjet) normale
Pasuria	Debitore
Kapitali aksionar	Kreditore
Detyrimet	Kreditore
Fitimi i mbajtur	Kreditore
Të hyrat	Kreditore
Shpenzimet	Debitore
Dividendët	Debitore

Analiza dhe evidenca e transaksioneve në llogaritë e librit kryesor

Çdo transaksion, i cili i plotëson kushtet për t'u regjistruar në librat e kontabilitetit, ndikon në rritjen ose zvogëlimin e llogarive të pasurisë, kapitalit aksionar dhe detyrimeve.

Përdorimin e termave të debisë dhe kredisë për regjistrimin e transaksioneve, po e ilustruam në vazhdim nëpërmjet një shembulli duke interpretuar analizën e transaksioneve dhe prezantuar regjistrimin e tyre në llogarinë T.

Shembull:

- 1) Më 1 mars 2007 Ermal Brovina ka filluar punën në një firmë të regjistruar si agjension turistik "Brovina Tours". Në këtë datë ai ka hapur një llogari bankare për firmën e tij dhe fillimisht ka deponuar 70,000 € kesh.
- a) Analiza: Është rritur llogaria e pasurisë, keshi. Gjithashtu është rritur një llogari e kapitalit, kapitali i pronarit Brovina.
- b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Rritjet e pasurisë regjistrohen në anën e debisë kurse rritjet e kapitalit regjistrohen në kredi.
- c) Regjistrimi i transaksit:

Keshi	Kapitali i "Brovina Tours"
1) 70.000	1) 70.000

2) Më 2 mars "Brovina Tours" ka blerë një lokal për zyre në Gjakovë, në vlerë prej 30.000 € me afatpagese për 2 muaj.

- a) Analiza: Është rritur një llogari e pasurisë, ndërtesat dhe gjithashtu është rritur një llogari e detyrimeve, furnitoret (llogaria e pagueshme).
- b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Rritjet e pasurisë regjistrohen në debi kurse rritjet e detyrimeve regjistrohen në kredi
- c) Regjistrimi i transaksionit:

Ndërtesat	
2) 30.000	

Furnitorët	
	2) 30.000

3) Më 3 mars “Brovina Tours” ka blerë mobilje dhe pajisje të tjera për zyre në vlerë prej 15.000 € me kesh.

a) Analiza: Është rritur llogaria e pasurisë, pajisjet. Njëkohësisht është zvogëluar një llogari e pasurisë, keshi.

b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Rritjet e pasurisë regjistrohen në debi, kurse zvogëlimet e pasurisë regjistrohen në kredi.

c) Regjistrimi i transaksionit:

Pajisjet	
3) 15.000	

Keshi	
1) 70.000	3) 15.000

4) Më 4 mars “Brovina Tours” ka shitur bileta dhe shërbime të tjera për 6.000 €. Nga këto shërbime të shitura për 1.000 € është pranuar keshi, kurse të tjerat janë shitur me afat pagese (kredit) për një muaj.

a) Ananliza: Është rritur llogaria e pasurisë keshi, për shumën e arkëtuar, dhe është rritur llogaria e pasurisë së blerësit, për shumën e shitur të shërbimeve me afat pagese. Gjithashtu është rritur një nënkategori e kapitalit, përkatësisht është rritur llogaria e të hyrave.

b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Rritjet e pasurisë regjistrohen në debi të llogarisë. Rritjet e llogarisë së të hyrave regjistrohen në kredi:

c) Regjistrimi i transaksionit:

Keshi	
2) 30.000	3) 15.000
4) 1.000	

Blerësit (l.e arkëtu.)	
4) 5.000	

Të hyrat	
	4) 6.000

5) Më 5 mars firma ka blerë në kesh 1.200 € një aparat të fotokopjes.

- a) Analiza: Është rritur një llogari e pasurisë, pajisjet. Është zvogëluar një llogari e pasurisë, keshi.
- b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Rritjet e llogarisë së pasurisë regjistrohen në debi kurse zvogëlimet në kredi.
- c) Regjistrimi i transaksionit:

Pajisjet	Keshi
3) 15.000	1) 70.000 3) 15.000
5) 1.200	4) 1.000 5) 1.200

6) Më 25 mars firma ka përmbushur me kesh detyrimin ndaj furnitorit lidhur me mobiljet e blera më parë në vlerë prej 15.000 €.

- a) Analiza: Është zvogëluar llogaria e pasurisë, keshi. Njëkohësisht është zvogëluar llogaria e detyrimeve, furnitorët.
- b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Zvogëlimet e pasurisë regjistrohen në kredi kurse zvogëlimet e detyrimeve regjistrohen në anën e debisë.
- c) Regjistrimi i transaksionit:

Keshi	Furnitorët (ll. e pagueshme)
1) 70.000	6) 15.000 2) 30.000
4) 1.000	5) 1.200

7) Më 29 mars “ Brovina Tours ” ka paguar në kesh këto shpenzime operative: 300 € për shpenzime të rrymes, 1.200 €, për pagat dhe 100 € në emër të shpenzimeve të ujit.

- a) Analiza: Është zvogëluar një llogari e pasurisë, keshi. Janë rritur tri llogari të shpenzimeve: shpenzimet e rrymes, shpenzimet e pagave dhe shpenzimet e ujit. Shpenzimet e rrymes dhe ujit ndryshe emërtohen shpenzime të shërbimeve publike.

b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Zvogëlimet e pasurisë regjistrohen në kredi. Rritjet e llogarive të shpenzimeve regjistrohen në kredi.

c) Regjistrimi i transaksionit:

Keshi		Shpen. Shërb. Publike	Shpenzimet e pagave	
2) 30.000	3) 15.000	7) 400	7) 1.200	
4) 1.000	5) 1.200			
	6) 15.000			
	7) 1.600			

8) Më 30 mars firma ka përmbushur me kesh detyrimin ndaj furnitorit lidhur me ndërtesat e blera më parë në vlerë prej 14.000 €.

a) Analiza: Është zvogëluar llogaria e pasurisë, keshi. Njëkohësisht është zvogëluar llogaria e detyrimeve, furnitorët.

b) Konform rregullave të debisë dhe kredisë: Zvogëlimet e pasurisë regjistrohen në kredi kurse zvogëlimet e detyrimeve regjistrohen në anën e debisë.

c) Regjistrimi i transaksionit:

Keshi		Furnitorët (LL/P)	
2) 30.000	3) 15.000	6) 15.000	2) 30.000
4) 1.000	5) 1.200	8) 14.000	
	6) 15.000		
	7) 1.600		
	8) 14.000		

9) Më 31 mars pronari i “Brovina Tours” ka tërhequr prej firmës për nevoja personale 200 € kesh.

a) Analiza: Është rritur një llogari e pasurisë, llogaria tërheqjet e pronarit “Brovina Tours”. Është zvogëluar një llogari e pasurisë keshi, llogaria tërheqja e pronarit është llogari e përkohëshme dhe llogari e kundër e kapitalit të pronarit.

b) Konform rregullave të debisë dhe krëdisë: Rritjet e pasurisë regjistrohen në debi, kurse zvogëlimet regjistrohen në kredi.

c) Regjistrimi i transaksionit.

Keshi		Tërheqjet e pronarit	
2) 30.000	3) 15.000	9) 200	
4) 1.000	5) 1.200		
	6) 15.000		
	7) 1.600		
	8) 14.000		
	9) 200		

Regjistrimi i transaksioneve në ditar

Në sistemin e kontabilitetit në praktikë, informacionet lidhur me transaksionin afarist, së pari regjistrohen në ditar. Evidenca e transaksioneve në ditar bëhet në mënyrë kronologjike, sipas datave të ndodhjes së tyre.

Në trajtimin e mëherëshëm lidhur, me evidencën e transaksioneve, drejtpërdrejt në llogaritë e librit kryesor kishin për objektiv të kuptuarit efektiv të transaksioneve në rritjet dhe zvogëlimet e pasurisë, kapitalit aksionar dhe detyrimeve. Edhe pse në aspektin teknik është i mundur të bëhet drejtpërdrejt regjistri në llogaritë e librit kryesor, megjithatë të gjitha transaksionet fillimisht regjistrohen në ditar për disa arsye.

a. **Në radhë të parë ditari ofron një informacion komplet nga një burim lidhur me një transaksion.** Në këtë rast, në ditar, shumat e debisë dhe krëdisë të një transaksioni regjistrohen së bashku, për dallim nga evidenca në llogaritë e librit kryesor, ku të njëjtat evidencohen ndaras në llogari të veçanta.

b. **Përdorimi i ditarit në regjistrimin e transaksioneve mundëson eliminimin e gabimeve që lidhen me evidencën e shumave në debi dhe kredi.** Përderisa tek regjistrimet e transaksioneve në

debi dhe kredi të llogarive të librit kryesor janë të mundëshme gabimet për shkak të evidencës së dyfishtë të debisë ose kredisë, në ditar gabimet e tilla edhe nëse ndodhin eliminohen menjëherë. Një situatë e tillë për vetë faktin se barazimi i totalit të debisë dhe kredisë në ditar bëhet për çdo transaksion të regjistruar.

Meqenëse ditari është njësia e parë bazike që përdoret për evidencën e transaksioneve, kontabilistët e quajnë **libër të evidencës burimore**.

Procesi i regjistrimit të transaksioneve në ditar quhet **ditarizim**. Transaksionet fillimisht regjistrohen në ditar dhe pastaj bartën në llogaritë e librit kryesor.

Procesi i bartjes së regjistrimeve nga ditari në llogaritë e librit kryesor quhet **bartje (posting)**.

Firmat në praktikë përdorin forma të ndryshme të ditarëve. Dy llojet kryesore të ditarëve janë:

- a) Ditari i përgjithshëm
- b) Ditari i veçantë

Ditari i përgjithshëm është formati më i thjeshtë, i cili përdoret më së shumti në praktikën kontabël. Firmat ndonjëherë në praktikë përdorin edhe ditarin e veçantë për blerësit, furnitorët etj.

Procedura e regjistrimit të transaksioneve në ditarët e veçantë është e ngjashme me procedurën e regjistrimit në ditarin e përgjithshëm.

Procesi i regjistrimit në ditarin e përgjithshëm zhvillohet në tre hapa:

1. Analizohen efektet e transaksionit në rritjet dhe zvogëlimet e llogarivë të pasurisë, kapitalit aksionar dhe detyrimeve.
2. Duke i zbatuar rregullat e debisë dhe kredisë përcaktohet debiti dhe krediti i çdo llogarie të ndikuar nga transaksioni.
3. Regjistrohet transaksioni në ditar me një përshkrim të shkurtër, lidhur me përmbajtjen e transaksionit. Së pari regjistrohen llogaritë që debitojnë kurse në anën tjetër regjistrohen llogaritë që kreditojnë.

Diagrami i ditarit përfshin të dhënat për transaksionet të sistemuara në kolona si në vijim:

DITARI				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi

- a) Në kolonën për datën shënohen: data, muaji dhe viti i regjistrimit të transaksionit të parë. Shënimet për muajin dhe vitin nuk përseriten deri në fillim të faqes tjetër të ditarit ose në fillimin e muajit të ardhshëm.
- b) Në kolonën emri i llogarive dhe përshkrimi, fillimisht në të majtë, shënohen emrat e llogarive që debitojnë, kurse prej mesit të kësaj kolone, në të djathtë, shënohen llogaritë që kreditojnë. Shumat e llogarive, që kanë debituar, regjistrohen në kolonën e debisë, kurse shumat e llogarive që kanë kredituar regjistrohen në kolonën e kredisë. Një përshkrim i shkurtër i cili identifikon përmbajtjen e transaksionit shënohet për çdo regjistrim të transaksionit. Një rresht i zbrazët mbetet pas çdo transaksioni të regjistruar në mënyrë që në faqën e ditarit, të dallohen ndërmjet veti transaksionet e regjistruara.
- c) Në kolonën e referencës shënohen numrat e llogarive të librit kryesor. Zakonisht këta numra të llogarive vendosën në këtë kolonë pasi që më parë të jetë transferuar shuma në llogarinë e librit kryesor.

Ilustrimin e regjistrimit të transaksioneve në ditar po e bëjmë në vazhdim duke u nisur nga të dhënat e firmës “Brovina Tours”.

Shembull:

Le të supozojmë se gjatë muajit mars te firma “ Brovina Tours” kanë ndodhur këto transaksione:

- 1) Më 1 mars 2007 Ermal Brovina ka filluar punën në një firmë të regjistruar si agjension turistik “Brovina Tours”. Në këtë datë ai ka hapur një llogari bankare për firmën e tij dhe fillimisht ka deponuar 70,000 € kesh.
- 2) Më 2 mars “Brovina Tours” ka blerë një lokal për zyre në Gjakovë, në vlerë prej 30.000 € me afatpagese për 2 muaj.
- 3) Më 3 mars “Brovina Tours” ka blerë mobilje dhe pajisje të tjera për zyre në vlerë prej 15.000 € me kesh.
- 4) Më 4 mars “Brovina Tours” ka shitur bileta dhe shërbime të tjera për 6.000 €. Nga këto shërbime të shtura për 1.000 € është pranuar keshi, kurse të tjerat janë shitur me afat pagese (kredit) për një muaj.
- 5) Më 5 mars firma ka blerë në kesh 1.200 € një aparat të fotokopjes.
- 6) Më 25 mars firma ka përmbushur me kesh detyrimin ndaj furnitorit lidhur me mobiljet e blera më parë në vlerë prej 15.000 €.
- 7) Më 29 mars “Brovina Tours” ka paguar në kesh këto shpenzime operative: 300 € për shpenzime të rrymes, 1.200 €, për pagat dhe 100 € në emër të shpenzimeve të ujit.
- 8) Më 30 mars firma ka përmbushur me kesh detyrimin ndaj furnitorit lidhur me ndërtesat e blera më parë në vlerë prej 14.000 €.
- 9) Më 31 mars pronari i “Brovina Tours” ka tërhequr prej firmës për nevoja personale 200 € kesh.

Libri kryesor (i madh)

Pas regjistrimit të transaksioneve në ditar, hapi tjetër në procesin kontabël konsiston me bartjen e tyre në llogaritë e librit kryesor. Fizikisht pothuajse llogaritë mbahen në librin kryesor.

Në sistemin kontabël libri kryesor praktikisht është një fletore e rëndomtë, në të cilën në çdo faqe të saj është e vendosur një llogari. Në sistemin e kumpjuterizuar libri kryesor mund të jetë një fajl ose një skader kompjuteri.

Shumat në debi dhe kredi të llogarive të librit kryesor janë në fakt shuma të debisë dhe kredisë të bartura nga ditari.

Llogaria **T** e trajtuar më lart përdoret kryesisht në studimet dhe librat e kontabilitetit sepse nëpërmjetë saj ofrohet një pasqyrë përmbledhëse, lidhur me ndikimet financiare të transaksioneve. Ndryshe nga kjo në praktikë përdoret formati i llogarisë me disa kolona i cili ofron një pasqyrë më të detajizuar, lidhur me efektet e transaksioneve.

Çdo llogari përbhet prej këtyre kolonave të veçanta:

- a) Kolona e parë shënon datën e transaksionit.
- b) Kolona e përshkrimit e cila përdoret për të shënuar ndonjë njoftim të veçantë.
- c) Kolona e referencës së ditarit në të cilën faqja e ditarit.
- d) Kolona e debisë në të cilën shënohet shuma e debituar.
- e) Kolona e kredisë me shumën e kredituar.
- f) Kolona e saldës në të cilën shënohet saldo debitore dhe kreditore.

Ilustrimin e ndërlidhjes së ditarit, në librin kryesor, po e prezantojmë në vijim me transaksionin e parë të shembullit “Brovina Tours”.

DITARI			Faqja nr.1	
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi
01.03.2007	Keshi	1	70,000	
	Kapitali i pronarit	2		70,000
	Investimet fillestare të pronarit			

Keshi		Llogaria nr.1				
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
01.03.2007		1	70,000		70,000	
03.03		1		15,000	55,000	
04.03		1	1,000		56,000	
05.03		1		1,200	54,800	
25.03		1		15,000	39,800	
29.03		1		1,600	38,200	
30.03		1		14,000	24,200	
31.03		1		200	24,000	

Kapitali i pronarit		Llogaria nr.2				
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
01.03.2007		1		70,000		70,000

Ndërtesat					Llogaria nr.3	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
02.03.2007		1	30,000		30,000	

Furnitorët (LL/P)					Llogaria nr.4	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
02.03.2007		1		30,000		30,000
15.03		1	15,000			15,000
30.03		1	14,000			1,000

Pajisjet					Llogaria nr.5	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
03.03.2007		1	15,000		15,000	
05.03		1	1,200		16,200	

Blerësit (LL/A)					Llogaria nr.6	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
04.03.2007		1	5,000		5,000	

Të hyrat nga shitja					Llogaria nr.7	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
01.03.2007		1		6,000		6,000

Shpenzimet e shërbimeve publike					Llogaria nr.8	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
029.03.2007		1	400		400	

Shpenzimet e pagave					Llogaria nr.9	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
29.03.2007		1	1,200		1,200	

Tërheqja e pronarit					Llogaria nr.10	
Data	Përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi	Saldo	
					Debi	Kredi
31.03.2007		1	200		200	

Bilanci vërtetues (provues)

Bilanci vërtetues është një mjet ndihmës i cili përdoret në përgatitjen e bilancit të gjendjes. Ai praktikisht përfshin saldot e të gjitha llogarive të librit kryesor, për të dëshmuar se shuma e llogarive me saldo debitore është e barabartë me shumën e llogarive me saldo kreditore. Në këtë mënyrë bilanci vërtetues shërben si një lloj kontrolli për të konstatuar gabimet e mundshme gjatë evidencës së transaksioneve në ditar dhe librin kryesor.

Ai përbëhet prej tri kolonave: në kolonën e parë regjistrohen emrat e llogarive, në kolonën e dytë raportohen në mënyrë të përmbledhur, saldot debitore të llogarive dhe në kolonën e tretë raportohen saldot kreditore të llogarive.

Në qofë se shuma e përgjithshme në kolonat e debisë dhe kredisë janë të barabarta, kjo është dëshmi se gjatë procesit të evidencës kontabël nuk ka pasur gabime dhe anasjelltas në qoftë se shumat e kolonave të debisë dhe kredisë nuk janë të barabarta, atëherë rrjedh se gjatë procesit të evidencës kontabël janë lëshuar gabime.

Bilanci provues mund të ndërtohet në çdo kohë, por zakonisht firmat e bëjnë në fund të periudhës kontabël.

Faza e dytë e ciklit kontabël fillon me përfundimin e periudhës kontabël. Në startin e fazës së dytë të ciklit kontabël është ndërtimi i bilancit vërtetues pa veprimet rregulluese.

Ilustrimin e ndërtimit të bilancit provues përpara veprimeve rregulluese po e prezantojmë nga të dhënat e shembullit të firmes “BrovinaTours”.

Fillimisht po i marrim saldot përfundimtare të të gjitha llogarive të librit kryesor.

Keshi		Kapitali i pronarit		Ndërtesat	
1) 70,000	3) 15,000		1) 70,000	2) 30,000	
4) 1,000	5) 1,200				
	6) 15,000				
	7) 1,600				
	8) 14,000				
	9) 200				
24,000 Saldo			Saldo 70,000		Saldo 30,000
Blerësit (LL/A)		Të hyrat nga shitja		Furnitorët (LL/P)	
4) 5,000			4) 6,000	6) 15,000	2) 30,000
				8) 14,000	
Saldo 5,000			Saldo 6,000	Sal. 1,000	
Pajsijet		Shpenzimet operative		Shpenzimet e pagave	
3) 15,000		7) 400		7) 1,200	
5) 1,200					
Sal. 16,200		Sal. 400		Sal. 1,200	

Tërhejqa e pronarit	
9) 200	
Saldo 200	

Bilanci vërtetues përpara rregullimeve

Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
Keshi	24,000	
Kapitali i pronarit		70,000
Ndërtesat	30,000	
Pajsijet	16,200	
Blerësit	5,000	
Furnitorët		1,000
Të hyrat nga shitja		6,000
Shpenzimet e pagave	1,200	
Shpenzimet e shërbimeve publike	400	
Tërhejqa e pronarit	200	
Totali	77,000	77,000

Evidenca për pagat

Kuptimi për pagat

“ Kush punon fiton “ (*popullore*)

Paga paraqet shumën monetare që merr punëtori për punën e bërë.

Paga është një komponent i rëndësishëm për menaxhimin e burimeve njerëzore, kjo është edhe arsyeja kryesore pse njerëzit punojnë.

Çfarëdo shume që punëdhënësi paguan në para ose në mall si kompensim për shërbimet e ofruara të punonjësit gjatë kohës së punësimit, në bazë të kontratës së punës, të formuluar ose të nënkuptuar, me gojë ose me shkrim. Paga përfshin rrogën, bonuset, shtesat, përqindjet, të mirat materiale (në natyrë) ose ndonjë formë tjetër të pagesës lidhur me punësimin.

Punonjësit mundë të shohin pagën si kompensim për punën e bërë. Një pagë është kompensim monetar (ose shpërblim) që punëdhënësi paguan për një punonjës në këmbim të punës së kryer. Pagesa mund të llogaritet si një shumë fikse për çdo detyrë të përfunduar, ose me një normë për orë ose për ditë pune, ose në bazë të një sasive të matur lehtësisht për punën e kryer (p.sh. 10 m kanal i hapur, 200 m² lyerje) etj.



Figura 19. Paga si shpërblim për punën e kryer. Burimi:www.baltictimes.com

Historiku i pagave është mjaft i lashtë. Paga e ka zanafillën e vet nga ushtria. Ajo lidhet me një shumë të vogël parash (sold), që u paguhej ushtarëve për të blerë krip. Gjatë sistemeve të ndryshme

ekonomiko – shoqërore paga u zhvillua dhe ju përshtat ndryshimeve që ndodhën në kushtet dhe marrëdhëniet e punës, për të arritur deri në ditët tona ku ajo përkufizohet si shprehje monetare e çmimit të punës së harxhuar nga ana e punëmarrësit.

- a) Në periudhën e skllavërisë dhe bujkrobisë pjesa e punës ekzekutohej nga skllavërit, të cilët merrnin si shpërblim nga skllavopronarët ushqimin, banesën dhe artikuj të tjerë të nevojshëm për jetën.
- b) Në periudhën e mesjetës punëtorët fituan njëfarë lirie. Në qendrat urbane artizanet siguronin kushte jetese, punësim dhe paga më të mira se sa punëtorët e bujqësisë.
- c) Në periudhën e revolucionit industrial banoret e zonave rurale gjithnjë e më shumë braktisnin tokat për të kërkuar punë në fabrika ku përfitonin paga më të larta dhe liri më të madhe. Një pjesë e shpërblimit jepej në formë kuponësh që me vonë punëtorët i këmbenin në magazinat e sipërmarrësve me mallrat e domosdoshme për jetesë.

Në periudhën pas industriale paga i jepet punëmarrësit tërësisht në formë monetare. Ata ishin të lirë dhe blinin çfarë dëshironin. Ata janë të lirë të ndryshonin punën duke rënë dakord me punëdhënësin.¹

Qëllimi i llogaritjes së pagave

Paga është masa monetare që korrespondon me njësitë standarde të kohës së punës, ose me një sasi standarde të punës së kryer, e përcaktuar si një normë. Qëllimi i vlerësimit të punës është një mënyre për të sqaruar se çka pritët nga puna. Ajo ndihmon në zhvillimin e standardeve për punë të kënaqshme duke cilësuar sasinë dhe cilësinë e punës. Në ditën e sotme punëdhënësit mund të zgjedhin midis një numri të madh elementesh për përcaktimin e pagës. Tradicionalisht burimet njerëzore ose punëtorët janë të ndarë në nivele ku çdo nivel korrespondon një skeme pagese dhe procesit i përcaktimit të pagës. Ka shume tipe të pagave megjithatë shumë organizata kanë një sistem të tillë që i përshin të dy tipet.

¹ www.uamd.edu.al/

Vlerësimi i punës (VP) është përcaktimi sistematik i vlerës së çdo elementi të punës. Vlerësimi i performancës (VP) është sistem me anë të së cilës përcaktohet se si një punëtor është duke e kryer punën e tij. Është një proces, që për qëllim ka dizajnimin e strukturës së pagës dhe nuk ka të bëjë me vlerësimin e performancës së punëtorit. Hapi i parë në drejtim të vlerësimit të punës është mbledhja e informatave nga përshkrimi i vendit të punës dhe përcaktimi i faktorëve që do të përdoren për të përcaktuar vlerën e çdo pune. Si faktorë paraqiten: dituria, shkalla e përgjegjësisë, kushtet e punës, energjia që duhet shpenzuar. Të ardhurat nga puna paraqesin burimin kryesor të fitimit për pjesën dërmuese të njerëzve. Në kuadër të tyre pagat dhe të hyrat tjera nga puna përfaqësojnë edhe pjesën më të madhe të të ardhurave kombëtare të çdo vendi.



Figura 20. Mjete e pagesës - €. Burimi: www.123rf.com

Ndarja e pagave

Për secilin punëtor, punëdhënësi duhet t'i ketë kontratat e nënshkruara nga punëdhënësi dhe i punësuari, duhet të jenë të vullosura nga punëdhënësi. Në kontratë përcaktohet pozita e punës, detyrat e punës, data e fillimit, afati i punës, kompensimi, detyra tjera në bazë të marrëveshjes, etj.

Në ditën e sotme punëdhënësit mundë të zgjedhin midis një numri të madh elementesh për përcaktimin e pagës. Tradicionalisht burimet njerëzore ose punëtorët janë të ndarë në nivele ku çdo nivel korrespondon një skeme pagese dhe procesit i përcaktimit të pagës.

Llojet e pagave:

1. Paga në bazë të rezultateve (sasive)

Përparësi: - Paga lidhet me efikasitetin

Mangësi: - Nuk është e aplikueshme në të gjitha organizatat

2. Paga ne baze të gradimit

Përparësi: - Është e barabartë për personat e së njëjtës gradë

Mangësi: - Nuk lidhet me efikasitetin

3. Paga në bazë të aftësive/diturive

Punëtori paguhet në bazë të aftësive që ka dhe që kërkohen për punën e caktuar. Kjo është metodë e cila dita ditës përdoret më shumë.

Përparësi: - Shpërblehet dituria

Mangësi: - Vështirësitë ne matjen e diturisë

Përcaktimi i pagës behet në tregun e punës, përmes ndërveprimit të ofertës dhe kërkesës për punë. Lartësia e pagave, marrë parimisht, shpreh nivelin e zhvillimit të përgjithshëm të forcave prodhuese të vendit. Ndryshueshmëria e nivelit të pagave nuk është i ndryshëm vetëm ndërmjet shteteve të ndryshme të botës, por edhe në kuadër të një vendi, lëmi, dege, territori, shtresave të ndryshme të popullsisë etj.

Faktorët kryesor që ndikojnë në lartësinë e pagave mundë të jenë: niveli i zhvillimit ekonomik, niveli arsimor, gjinia, etj.



Figura 21. Lartësia e pagave. Burimi:www.publicpolicy.ie

Qëllimi kryesor i ndërtimit të një sistemi efektiv të pagave është ndërtimi i një strukture të qëndrueshme për kompensimin e punëtorëve varësisht nga puna e tyre dhe shkalla e treguar e performancës.



Figura 22. Pagat në bazë të gradimit. Burimi: <http://www.propublica.org/>

Tatimet dhe kontributet në paga

Të gjithë individët, rezidentë dhe jo-rezidentë, që fitojnë të ardhura nga pagat në Kosovë, do të konsiderohen të punësuar dhe janë të obliguar të paguajnë tatim në të ardhurat personale nga pagat, përveç të punësuarave të huaj në trupat e përcaktuara në Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale në Kosovë.

Çdo punëdhënës është i obliguar **të ndal tatimin** në burim nga të ardhurat bruto të pagave të punësuarve të tij gjatë secilës periudhë të caktuar.

Për kontributet pensionale, çdo punëdhënës është i detyruar që të kontribuoj në emër të punonjësve dhe atë nga dita e parë e punësimit.

Shuma që është i obliguar të paguaj punëdhënësi në emër të punëtorit është 5% e të ardhurave bruto të punëtorit, mirëpo punëdhënësi mund të kontribuojë në mënyrë vullnetare deri në maksimumi 15% në emër të punëtorit. E njëjta vlen edhe për punonjësit të cilët duhet që

Obligimi i punëdhënësit
5% -15%
Obligimi i Punëmarrësit
5%-15%

Punëdhënësi duhet të ndalë në burim edhe 5% - 15% nga paga bruto e punëtorit, dhe t'i paguajë ato menjëherë në formë të kontributeve pensionale.²

Kur nga paga bruto zbriten kontributet pensionale atëherë pjesës së mbetur i referohemi si “të ardhura të tatueshme”. Të gjithë individët, rezidentë dhe jo rezidentë, që fitojnë të ardhura nga pagat në Kosovë do të konsiderohen të punësuar dhe janë të obliguar të paguajnë tatim në të ardhurat personale nga pagat, përveç të punësuarve të huaj në trupat e përcaktuara në **Ligji Nr. 03/L-161 për Tatimin në të ardhura personale**.

Secili i punësuar, pavarësisht a punon për një apo më tepër punëdhënës, obligohet të ***caktojë punëdhënësin kryesor***, duke plotësuar Formularin për caktimin e punëdhënësit kryesor (FCPK), brenda 15 ditëve nga dita e fillimit të punës. Këtë formular duhet ta dorëzojë në Zyrën përkatëse të Shërbimit të Tatimpagueseve në Administratën Tatimore të Kosovës.

Punëdhënësit të cilët nuk janë të zgjedhur si punëdhënës kryesor nga i punësuar i tyre, do të trajtohen si punëdhënës dytësor (sekondar) për çështjet tatimore.

² Ligji Nr. 03/L-161 për Tatimin në të ardhura personale



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



FORMULARI I CAKTIMIT TË PUNËDHËNËSIT KRYESOR

[2] Numri serial:

2064495

Informatat e të Punësuarit

[1] Emri dhe Mbiemri: Klajdi Allu

[3] Numri Personal: 1088212777

[4] Adresa : Rr. "Adem Jashari" pn

[5] Telefoni: _____

[6] Vendi Prizren

[7] Komuna Prizren

[8] Pozita/Titulli Teknik i kontabilitetit

[9] Data e Fillimit të Punësimit: 02.01.2015

Unë, i nënshkruari nëpërmjet kësaj forme caktoj punëdhënësin e mëposhtëm si punëdhënësin tim kryesor

Informatat e Punëdhënësit

[10] Emri i Bizne ~~XXXX~~ FU "Bauhaus"

[11] Numri Fiska ~~XXXX~~ 20010010

[12] Pronari/Men ~~XXXX~~

[13] Telefoni: ~~XXXX~~

[14] Adresa: ~~XXXX~~

[16] Vendi: ~~XXXX~~ Prizren

[17] Komuna ~~XXXX~~ Prizren

(*) Nëse i Punësuarit nuk ka numër Personal ai/ajo duhet të aplikoj në Administratën Tatimore për t'u pajisur me një Numër Individual të Tatimpaguesit brenda 15 ditëve nga dita e fillimit të punës.

Emri dhe Nënshkrimi i të Punësuarit

(_____)

Data: _____

Punëdhënësit kryesor duhet të llogarisin (për çdo muaj të mbajnë tatimin në burim në paga) dhe të paguajnë tatimin sipas grupimeve të pagave dhe shkallëve tatimore të dhëna në tabelën në vijim:

Shkallët tatimore mujore		Të ardhurat e tatueshme	Përqindja e tatimit	Tatimi mujor
1	2	3 (2-1)	4	5 (3 x 4)
0.00	80.00	80.00	0%	0.00
80.00	250.00	170.00	4%	6.80
250.00	450.00	200.00	8%	16.00
450.00	Mbi	0.00	10%	0.00
Gjithsej vlera e tatimit				

Tabela 4. Shkallët tatimore. Burimi: www.atk-ks.org.

Për punëdhënësin sekondar duhet ta llogarisim (për çdo muaj të mbajnë tatimin në burim) dhe të paguajnë tatimin, vetëm me shkallën maksimale **10%**.

Kursimet Pensionale

Për financimin e kursimeve pensionale, punëdhënësi paguan shumën prej së paku 5% të vlerës së pagës bruto të punonjësve si dhe punonjësi paguan shumën gjithashtu së paku 5% të pagës bruto të tij/saj.

Prej 1 Gushti 2003, të gjithë punëtorët, që janë banorë të përhershëm të Kosovës, janë të obliguar t'i mbajnë në burim dhe të paguajnë kontributet për kursimet pensionale në një llogari të veçantë për secilin të punësuar të hapur në Trustin për Kursime Pensionale.

Gjithashtu edhe punëdhënësit, janë të obliguar që për të punësuarit e tyre rezidentë, të paguajnë një shumë të caktuar të kontributeve pensionale³.

³ Rregullorja Nr. 2005/20 -Mbi Pensionet në Kosovë

Programi i kursimeve pensionale mbulon të gjithë punëtorët rezident në Kosovë

Pyetje: Sa janë kontributet pensionale (minimale) mujore të një të punësuarit nëse paga bruto e tij/saj është 400 € në muaj?

Përgjigje: Kontributet pensionale të të punësuarit dhe punëdhënësit do të jenë 40 € në muaj. Kjo kalkulohet në këtë mënyrë:

- | | |
|--|--|
| i. Kontributi i të punësuarit për pensionet individuale: | <u>5%\times400 € = 20 €</u> |
| | + |
| ii. Kontributi i punëdhënësit për pensionet e të punësuarit: | 5% \times 400 € = 20 € |

Shembulli.3. Llogaritja e kontributeve pensionale. Burimi: www.atk-ks.org

Tatimi i mbajtjes në burim së bashku me kontributet pensionale deklarohen në mënyrë elektronike përmes procesit të Deklarimit Elektronik (EDI), sistem ky i përbashkët i ATK-së dhe TRUST-it. Për të përdorur këtë sistem punëdhënësi duhet të regjistrohet në webfaqen e ATK-së: www.atk-ks.org, ku i gjenerohet një parullë përmes së cilës ka qasje vetëm ky tatimpagues përmes së cilës deklaron tatimet dhe kontributet. EDI verifikon nëse shumat e kontributeve të të punësuarit apo punëdhënësit janë brenda këtyre limiteve. Nëse kontributin pensional p.sh. e keni shënuar nën 5% të pagës bruto, sistemi do t'ju lajmërojë për këtë gabim, dhe mu në rreshtin e gabuar, mund të bëni përmirësimin duke klikuar në të. EDI nuk ju lejon të kaloni këtë pikë, pa bërë përmirësimin!

Deklarimi i pagave dhe pensioneve

The screenshot shows the web interface for declaring pension contributions. At the top, there is a header for the 'Administrata Tatimore e Kosovës' (Tax Administration of Kosovo) and the 'Ministria e Financave' (Ministry of Finance). The page title is 'Deklarimi i pagave dhe pensioneve'. The form includes several fields: 'Arsyeja' (Reason) set to 'DEKLARIM', 'Periudha' (Period) set to '8/2011', and 'NR. Fiskal' (Tax ID) set to '600542080'. There is an 'Excel File' section with a 'Choose File' button and the text 'No file chosen'. A checkbox is present with the text 'Nëse kjo deklaratë dorëzohet për të raportuar një kontribut vullnetar ose të tjera.' (If this declaration is submitted to report a voluntary contribution or other). A 'Dërgo' (Send) button is at the bottom of the form.

Figura 23. Deklarimi i pagave dhe pensioneve. Burimi: www.atk-ks.org


Emri	Mbiemri	Numri Individual i punëtorit	Bruto paga për muaj	Kontributi pensional i të punësuarit	Kontributi pensional i punëdhënësit	Kontributi suplementar i të punësuarit	Kontributi suplementar i punëdhënësit	Punë Primare	Përfshihen Kontributet
a	b	c	d	e=(d*5%)	f=(d*5%)	g	h	i	j
Blerim	Dakaj	1019694225	430 21.5	21.5				PO	PO
Florije	Gashi	1019694921	400 20	20				PO	PO
Atdhe	Morina	1001051924	350					PO	JO
Bashkim	Mallqi	1014205215	350 17.5	17.5				PO	PO
Fisnik	Berisha	1135066210	320 16	16				PO	PO
Bedri	Hoti	1002031433	320 16	16				JO	PO
Arion	Destani	1250402003	300 15	15				PO	PO
Bajram	Bajrami	1011025925	280 14	14				JO	PO
Nexhat	Berisha	1000254365	280 14	14				JO	PO
Demir	Morina	2012220153	280 14	14				JO	PO

Figura 24. Formulari me të cilin bëhet ngarkimi në EDI dhe përlogaritja e tatimeve dhe e kontributeve. Burimi: www.atk-ks.org/



Figura 25. Shkarkimi i dëftesës për pagesë pas deklarimit të suksesshëm. Burimi: www.atk-ks.org/

Në anën e majtë të faqes do të shihni figurën si më poshtë.



Klikoni mbi *Shkarko mostrën* dhe dokumentin e shkarkuar ruajeni në kompjuterin tuaj. Më pastaj po të njejtin dokument plotësojeni duke i respektuar udhëzimet si në vijim .

Figura 26. Butoni i shkarkimit të mostrës për deklarim apo deklarimeve të mëparshme. Burimi: www.atk-ks.org/

Punëdhënësit të cilët nuk janë të zgjedhur si punëdhënës kryesor nga i punësuari i tyre, do të trajtohen si punëdhënës sekondarë për çështjet tatimore.

Shembulli 4. Llogaritja e tatimit dhe kontributeve për pagën 450,00 €.

Punëdhënësit kryesorë duhet të llogarisin (për çdo muaj të mbajnë në burim) dhe të paguajnë tatimin sipas grupimeve të pagave dhe shkallëve tatimore të dhëna më lart:

Nëse një i punësuar punon vetëm te një punëdhënës, dhe atë e ka zgjedhur si punëdhënës kryesor duke plotësuar dhe dorëzuar formularin adekuat, për caktimin e punëdhënësit kryesor në Administratën Tatimore të Kosovës.

Paga mujore: **450,00 €**

Shpenzimet e rrugës (personale) **22,00 €**

Shpenzimet për ushqim **66,00 €**

Të ardhurat mujore bruto 538,00 €

Llogaritja mujore e Kontributeve për Kursime Pensionale dhe Tatimit në të Ardhurat

Personale është si më poshtë:

Të ardhurat e tatueshme = Të ardhurat bruto - zbritjet e lejueshme për kursime pensionale

<u>Paga bruto 538,00</u>	<u>=538,00 x 5%</u>	<u>26,90</u>	<u>+26,90 = 53,80</u>
<u>Paga e tatueshme: (538,00 - 26,90) = 511,10</u>			
<u>0,00 deri 80,00</u>	<u>=80,00 x 0%</u>	<u>0,00</u>	
<u>80,00 deri 250,00</u>	<u>=180,00 x 4%</u>	<u>6,80</u>	
<u>250,00 deri 450,00</u>	<u>=200,00 x 8%</u>	<u>16,00</u>	
<u>=(511,10 - 450,00)</u>	<u>=61,10 x 10%</u>	<u>6,11</u>	
<u>Totali i tatimit mujor</u>		<u>28,91</u>	
<u>Totali i kontributit mujor</u>		<u>53,80</u>	

Llogaritja mujore e kontributeve për kursim pensional dhe tatimit në të ardhurat personale nga punëdhënësi sekondar për pagën prej 100,00 € është:

<u>Paga bruto 100,00</u>	<u>=100,00 x 5%</u>	<u>5,00</u>	<u>+5,00 = 10,00</u>
<u>Paga e tatueshme: (100,00 - 5,00) = 95,00</u>			
<u>95,00</u>	<u>=95,00 x 10%</u>	<u>9,50</u>	
<u>Totali i tatimit mujor</u>		<u>9,50</u>	
<u>Totali i kontributit mujor</u>		<u>10,00</u>	

Deri me datën 15 të muajit pasues, punëdhënësi duhet të deklarojë në mënyrë elektronike përmes EDI-t, nga i cili në mënyrë automatike bëhet përlllogaritja e tatimit në paga dhe e Kontributit pensional, si dhe gjenerohet dëftesa për pagesën e tatimeve dhe kontributeve, e cila mund të paguhet në çdo institucion financiar të licencuar për pagesë në Kosovë apo edhe përmes pagesave elektronike nga tatimpaguesit.

Si pagesa, ashtu edhe raportimi i kontributeve të paguara janë përgjegjësi e punëdhënësit. I punësuarit duhet të ndihmojë punëdhënësin vetëm duke dhënë numrin e tij/saj të saktë të letërnjoftimit.⁴

Raportimi i tatimeve dhe kontributeve bëhet në bazë mujore.

Pagat bruto.

Paga bruto është shuma që punëdhënësi pajtohet t'i paguajë të punësuarit për punën e kryer dhe e cila brenda saj përmban edhe kontributet dhe tatimet që janë të parapara me ligjin ne fuqi.

Zakonisht pagat paguhet së paku një herë në një muaj edhe pse shërbimet e punësimit kryhen në baza ditore. Të ardhurat nga pagat do të përfshihen në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën paguhet paga nga punëdhënësi dhe pranohen nga i punësuarit dhe shpenzimi i pagës do të kërkohet nga punëdhënësi si zbritje e fitimit të tatueshëm në periudhën e njëjtë tatimore.

I njëjti parim vlen edhe për detyrimin për ndaljen e tatimit në burim në paga - ky detyrim lind vetëm kur pagat në të vërtetë janë paguar, e jo kur të jetë përlllogaritur detyrimi i pagave në librat e tatimpaguesit.

Çdo pjesë përbërëse e "pagave" që nuk është paguar në para të gatshme, duhet gjithashtu të përfshihet në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën është pranuar kjo komponentë. Të ardhurat bruto, sipas **Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatimin në të ardhura personale** përfshijnë të gjitha të ardhurat e marra ose akruara në formën e pagave gjatë periudhës tatimore;

- Të ardhura bruto nga pagat përfshijnë por nuk do të limitohen në: Rrogat e paguara nga ose në emër të punëdhënësit për punën e bërë nga i punësuarit sipas udhëzimeve të punëdhënësit;
- Bonuset, komisionet, dhe forma të tjera kompensimi që një punëdhënësi, ose dikush tjetër në emër të punëdhënësit, i paguan të punësuarit mbi rrogën;

⁴ www.atk-ks.org/

- Të ardhurat e fituara sipas kontratave për punë të përkohshme;
- Pensionet dhe të ardhura të tjera të paguara nga punëdhënësi i mëparshëm ose nga qeveria;
- Të ardhurat nga një punësim i ardhshëm, si p.sh një bonus për nënshkrimin e kontratës;
- Premi sigurimi që punëdhënësi paguan për një të punësuar;
- Faljen e borxhit ose obligimit të punësuarit ndaj punëdhënësit;
- Pagesën e shpenzimeve personale të punësuarit; dhe benefitet në natyrë që një

punëdhënës i jep të punësuarit, e cila tejkalon shumën minimale të specifikuar në udhëzimin administrativ.




Figura 27. Pagat bruto dhe neto. Burimi: <http://www.cesifo-group.de/>

Llogaritja e zërave të pagës: pagën bruto para sigurimeve dhe tatimeve, tatimet mbi të ardhurat personale, paga bruto për sigurimet, ndalesat për sigurimet e personelit, sigurimet e punëdhënësit, paga neto për tu paguar.

Pagat neto

Paga neto është shuma që i paguhet të punësuarit pasi të hiqen kontributet, tatimet dhe të gjitha ndalesat tjera që janë të parapara me ligjin ne fuqi.

Zbritjet e pagave për mbajtjen në burim mbi pagat janë diferenca midis pagës bruto dhe pagës neto.



Paga bruto është kompensimi i punëtorëve për punën dhe angazhimeve të tij gjatë muajit përkatës. Nga bruto paga zbritet fillimisht kontributi i punëmarrësit dhe formohet paga bazë për tatimin. Mbi atë bazë përllogaritet tatimi në paga sipas shkallëve tatimore. Nga bruto paga, zbritet tatimi dhe kontributi i punëmarrësit dhe formohet neto paga.

Mënyrat e llogaritjes së pagës bruto dhe pagës neto

Pagat zakonisht paguhen një, dy ose edhe më shumë herë në muaj. Ato llogariten si paga bruto duke zbritur kontributet dhe tatimet sipas ligjeve në fuqi.

Kalkulimi	(Shembull)					
Për pagën prej:	280	Euro	14,00	266,00	280,00	Paga
					14,00	Minus Kontr. Pens
					7,44	Minus tatimi në të ardhura
					258,56	Paga Neto

Paga	Prej	Deri	Shkalla	Gjithsej	
	0	80	0%	0,00	
	80	266,00	4%	7,44	
	Gjithsej tatimi në të ardhura person.				7,44

Kalkulimi	(Shembull)							
Për pagën prej:	350	Euro	17,50	332,50			350,00	Paga
							17,50	Minus Kontr. Pens
							13,40	Minus tatimi në të ardhura
							319,10	Paga Neto

(700 x 5 % Kontr. Pens = 35.00; 700 - 35 = 665)

Paga	Prej	Deri	Shkalla	Gjithsej		
	0	80	0%	0,00	80 Euro minus 0 Euro x 0% =	
	80	250	4%	6,80	250 Euro minus 80 Euro x 4% =	
	250	332,5	8%	6,60		
	Gjithsej tatimi në të ardhura personale				13,4	Shuma e pagës (pasi t'i hiqen 5% të Kontrib. Pens) minus 250 Euro x 8% =

Kalkulimi	(Shembull)							
Për pagën prej:	490	Euro	24,50	465,50			490,00	Paga
							24,50	Minus Kontr. Pens
							24,35	Minus tatimi në të ardhura
							441,15	Paga Neto

(700 x 5 % Kontr. Pens = 35.00; 700 - 35 = 665)

Paga	Prej	Deri	Shkalla	Gjithsej		
	0	80	0%	0,00	80 Euro minus 0 Euro x 0% =	
	80	250	4%	6,80	250 Euro minus 80 Euro x 4% =	
	250	450	8%	16,00	450 Euro minus 250 Euro x 8% =	
	450	465,5	10%	1,55		
	Gjithsej tatimi në të ardhura personale				24,35	Shuma e pagës (pasi t'i hiqen 5% të Kontrib. Pens) minus 450 Euro x 10% =

Tabela 28 a.b.c. Llogaritja e pagave.